




# NDËRHJRJE PËR SJELLJE POZITIVE

Udhëzues për prindërit  
dhe nxënësit



# NDËRHJRJE PËR SJELLJE POZITIVE

Udhëzues për prindërit dhe nxënësit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

unicef  | for every child



Publikimi “Ndërhyrjet për sjelljet pozitive”, Udhëzues për prindërit dhe nxënësit, u realizua në kuadrin e bashkëpunimit të YWCA of Albania me UNICEF-in. Opinionet dhe sugjerimet e paraqitura në këtë botim i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e UNICEF-it.

Autor: Dr. Florian Kulla



Design: petanidesign

Shtypi: Gent Grafik

Për hartimin e manualit kontribuan Znj. Shqiponja Lamçe, Specialiste e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, specialistë të Edukimit dhe e Fëmijërisë së Hershme në UNICEF si dhe shumë mësues e punonjës arsimor në vend.

Copyright 2019. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për YWCA of Albania dhe UNICEF, Tiranë, Shqipëri.

# PËRMBAJTJA

Hyrje..... faqe 6



## Kapitulli 1

### KONCEPTET KRYESORE TË NDËRHYRJEVE PËR SJELLJE POZITIVE TE NXËNËSIT DHE PRINDËRIT.. 8

Çfarë janë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive? .....	8
Çfarë nuk janë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive? .....	12
Pse mendojmë se Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive do të jenë efektive në shkollën tuaj? .....	14
Cilët janë disa elementët thelbësorë në zbatimin e NSP-ve? .....	15
Si funksionojnë në praktikë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive? .....	15
Po cilat janë, konkretisht, rregullat që umësohen nxënësve të shkollës përmes Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive? .....	18
Çfarë ndodh nëse nxënësit nuk zbatojnë normat/rregullat/pritshmëritë e vendosura së bashku? .....	18



## Kapitulli II

### PËRFSHIRJA E NXËNËSVE NË ZBATIMIN E METODOLOGJISË SË NDËRHYRJEVE PËR SJELLJE POZITIVE DHE KRIJIMIN E KLIMËS POZITIVE NË SHKOLLË ..... 20

Sa i rëndësishëm dhe i dobishëm mund të jetë angazhimi juajsi nxënës.....	21
Modeli i mëposhtëm tregon 5 nivelet e angazhimit të nxënësve në shkollë .....	22
Sa e rëndësishme është përvoja juaj në përfshirjen dhe angazhimin në aktivitetet e shkollës? .....	23
Tabela: Krahasoni angazhimin domethënës me ato jo domethënës.....	23
Modeli me gjashtë role i angazhimit të nxënësve në shkollë .....	24



Kapitulli III

**ROLI I PRINDËRVE NË ZBATIMIN E NDËRHYRJEVE PËR SJELLJE POZITIVE ..... 30**

Si mund t'i zbatoni Ndërhryret për Sjellje Pozitive në shtëpi?..... 30

PSE DUHET TË PËRFSHIHENI DHETË BASHKËPUNONI ME SHKOLLËN NË NDIHMËTË FËMIJËS SUAJ ..... 37

CILI ËSHTË ROLI JUAJ NË ZBATIMIN E NDËRHYRJEVE PËR SJELLJE POZITIVE..... 40



Kapitulli IV

**NDËRHYRJET PËR SJELLJE POZITIVE DHE FORMAT E PRINDËRIMIT POZITIV..... 43**

ÇFARË ËSHTË DISIPLINA? ..... 44

Mos ngatërroni ndëshkimin me disiplinën! ..... 45

Bindje të gabuara që nxisin ende ndëshkimin dhe dhunën ndaj fëmijëve..... 45

Praktika pozitive për të disiplinuar fëmijët e moshës 10 – 18 vjeç (fëmijët në moshën e pubertetit dhe adoleshencës)..... 47



## Shtojcat

Shtojca nr. 1. Model i Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në Shtëpi .....	55
Shtojca nr. 2. Shembuj të rregullave në shtëpi.....	56
Shtojca nr. 3. Shembull i zotimit të prindit .....	57
Shtojca nr. 4. Listë Kontrolli për Përfshirjen e Prindërve .....	58
Shtojca nr. 5. ANKETA E PERCEPTIMIT TË NXËNËSIT PËR Ndërhyrje për Sjellje Pozitive.....	60
Shtojca nr. 6. Komponentët kryesorë të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në shkollë .....	63
Shtojca nr. 7. Reflektim mbi zemërimin e prindërve .....	66
Shtojca nr. 8. Këshilla për prindërit e fëmijëve të rritur e adoleshentë.....	68
Shtojca nr. 9. Tri nivele: qasja trikëndore në ndërhyrjet e bazuara në shkollë.....	70
Shtojca nr. 10. Një letër për prindërit: Ju e bëni shkollën të jetë ajo që është .....	76



## HYRJE

### Të dashur nxënës dhe prindër!

Jemi të gëzuar që shkolla juaj, si pjesë e projektit “Programi i Ndërhyrjes për Sjellje Pozitive”, do të fillojë këtë vit të zbatojë një qasje të re në krijimin e një klime gjithëpërfshirëse e të sigurt në shkollë, qasjen që njihet si Ndërhyrje për Sjellje Pozitive (NSP).

Krijimi i mjediseve mikpritëse dhe të sigurta që përmirësojnë dhe lehtësojnë procesin e të nxënësve është përparësi e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe organizatave që punojnë në këtë fushë. Sigurisht ne besojmë se nxënësit dhe familjet e tyre kanë një rol kyç në krijimin e këtyre mjediseve. Si organizatë zbatuese e këtij projekti, dëshira jonë më e sinqertë është që nxënësit dhe prindërit të kuptojnë qartësisht dhe të pranojnë përgjegjësitë e sjelljes pozitive.

Ky udhëzues është hartuar për t’ju ndihmuar ju, nxënës e prindër, por edhe stafin e shkollës të kuptoni qasjen e re të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive, të cilat do të zbatohen pranë shkollave tuaja. Udhëzuesi është pjesë e një grupi dokumentesh dhe materialësh, që po hartohen në kuadër të këtij projekti, në mënyrë që të gjithë individët brenda dhe jashtë shkollës të kenë informacionin e duhur për ta zbatuar këtë qasje.

Nga përvojat tona në shkollë, të gjithë biem dakord, që pavarësisht nga përpjekjet e bëra ato nuk janë plotësisht të sigurta. Ky projekt është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme e vizionit tonë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, (MASR, UNICEF dhe YWCA) e për këtë arsye prej kohësh ne kemi punuar në promovimin dhe ndërtimin

e shkollave miqësore për fëmijët, në mënyrë që shkollat të kthehen në mjedise mikpritëse, gjithëpërfshirëse dhe të sigurta. Ne besojmë se nxënësit nuk mësojnë dot nëse nuk ndihen fizikisht dhe emocionalisht të sigurt. Në këtë aspekt, ne besojmë se qasja e prezantuar dhe strategjitë e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive janë një mënyrë për t'iu mundësuar të gjithë fëmijëve një mjedis sa më të mirë të nxënës.

Normat dhe rregullat për fëmijët dhe të rinjtë në shoqëri si e jona, që po ndryshon mjaft shpejt, janë një sfidë shumë e madhe në rritjen e fëmijëve. Nisur nga studimet e shumta, ne besojmë se edhe Programi i Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive që ka filluar të zbatohet në shkollën tuaj, paraqet një model, në të cilin theksohet vetëkontrolli dhe këmbëngulja e të rriturit, jo kontrolli i fëmijës; nxitja e ndërtimit të një rrjeti njerëzish që bashkëpunojnë, jo nxitja e një hierarkie strikte, marrja e përgjegjësisë, jo përdorimi i forcës fizike, transparencë, jo heshtje dhe sekrete. Ndërhyrjet për Sjellje pozitive janë praktike dhe të zbatueshme si për familjet, ashtu edhe për shkollën e komunitetin ku jeton fëmija.

Ju falënderojmë paraprakisht për mbështetjen tuaj!







# KAPITULLI I PARË

## KONCEPTET KRYESORE TË NDËRHYRJEVE PËR SJELLJE POZITIVE TE NXËNËSIT DHE PRINDËRIT

Në këtë kapitull të udhëzuesit do të sjellim në mënyrë të përmbledhur e në gjuhë të thjeshtë se çfarë janë Strategjitë e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive. Nëse keni interes të lexoni më shumë informacion për këtë qasje, mund të shkarkoni manualin përkatës të hartuar nga ekspertë të Agjencisë të Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar, që është pjesë e këtij projekti.<sup>1</sup>

### Çfarë janë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive?

Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive janë një sistem parandalues për menaxhimin e sjelljes në shkollë dhe në klasë, hartuar dhe përdorur në mënyrë të suksesshme në SHBA dhe në shumë vende të tjera. Ato bazohen në kërkime të shumta shkencore dhe në shkollat ku janë aplikuar, kanë sjellë ndryshime të dukshme në klimën sociale dhe sigurinë e saj. Për këtë arsye, kjo qasje po përqafohet çdo vit nga një numër gjithmonë e më i madh shkollash në të gjithë botën.

Në thelb të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive qëndron besimi se çdo individ meriton të trajtohet me **dinjitet** pavarësisht aftësive, prejardhjes, pamjes apo faktorëve të tjerë që shpesh kthehen shkak për ngacmim, keqtrajtim e abuzim. Parimi i



dinjitetit frymëzonte elementët e tjerët e rëndësishëm të bashkëjetesës në një vend, siç janë respekti, siguria, përgjegjshmëria. Këto tri parime kyçe të një bashkëjetese të shëndetshme jo vetëm në shkollë, por në çdo vend tjetër si shtëpi, institucione, rrugë, shërbime etj. përbëjnë bazën e demokracisë të zbatuar në jetën tonë të përditshme. Dakordësimi për këto tri parime të bashkëjetesës në shkollë përbën fillimin e zbatimit të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive. Mënyra sesi “do të përkthehet” respekti, siguria dhe përgjegjshmëria, jo vetëm nga nxënësit por nga çdokush që është pjesë e shkollës, dhe dakordësimi i të gjithëve për t’i zbatuar këto sjellje konkretisht në çdo vend të shkollës, përbëjnë “kontratën” e parë të përbashkët të bashkëjetesës demokratike. Kjo gjë krijon themelin për një gjuhë të përbashkët mes gjithë faktorëve dhe aktorëve në shkollë.

Për fat të keq, fjala “disiplinë” shpesh shihet nga shkolla si zbatim i procedurave të ndryshme, që zbaton shkolla, të cilat bazohen kryesisht te kontrolli dhe pasojat ndëshkuese për ata nxënës që “shkellin rregullat”. Kjo qasje tradicionale është e paplotë, nëse nuk i japim vëmendjen e duhur zhvillimit dhe mbështetjes së sjelljes pozitive. Në qasjen e re të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive disiplina konceptohet si “hapat ose veprimet që mësuesit, drejtuesit, prindërit dhe vetë nxënësit ndjekin, për të përmirësuar suksesin e nxënësit si në mësim edhe në sjellje”.

Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive bazohen në faktin se për krijimin e klimës pozitive në shkollë nuk janë përgjegjës vetëm mësuesit. Përkundrazi për atmosferën pozitive në shkollë, përgjegjësia bie mbi çdo individ të shkollës. Tek e fundit, përgjegjës për sjelljen e nxënësve duhet të jenë, së pari, vetë nxënësit e më pas të tjerët.

Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive bëjnë pjesë në format moderne dhe pozitive të disiplinimit dhe menaxhimit të sjelljes, pa përdorur asnjë formë ndëshkimi. Ato karakterizohen nga disiplinimi pozitiv, që ndërthuret me pikat e forta të fëmijës.

Në psikologjinë e sjelljes ka një parim themelor, sipas të cilit çdo njeri e përsërit një sjellje të caktuar, për sa kohë ajo sjellje po i shpërblehet. Fakti që shumë nxënës sillen dhunshëm, pa respekt, janë ngacmues e manipulues, janë impulsivë e



konfliktuale edhe në shkollë, në një formë a në një tjetër do të thotë se kjo sjellje po u shpërblehet, në të kundërt këto sjellje negative duhet të ishin reduktuar e jo të kishin pësuar rritje. Edhe nëse e dinë që janë sjellje të papërshtatshme, ata do të vazhdojnë t'i kryejnë këto sjellje për të plotësuar nevojat e tyre. Shpërblimet që marrin për këto sjellje vijnë si nga nxënësit e tjerë ashtu edhe nga prindërit e stafi. Në të kundërt, nëse sjellja nuk shpërblehet por dekurajohet, ajo ka prirje të ulet. Sipas të njëjtit parim veprojnë edhe Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive: përmes tyre nxiten dhe përforcohen sjelljet që bazohen në respekt dhe jo sjelljet që çenojnë respektin për individin, ndërkohë që individi që i shfaq këto sjellje ndihmohet t'i zëvendësojë ato me sjellje të pranueshme.

**Qëllimi i Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive është të bëjë të ditur se cilat janë sjelljet e pranueshme dhe ato jo të pranueshme në mjediset ku qëndron fëmija, përmes deklaratave të qarta e të shkruara me një gjuhë pozitive. Këto deklarata vendosen në mjedise të dukshme të klasës apo shtëpisë, në mënyrë që të njihen nga të gjithë, pra, jo vetëm nga fëmijët por edhe nga stafi e familjet. Një ndër hapat kryesorë në zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive është ndërtimi i një sistemi shpërblimi për nxënësit që shfaqin sjellje pozitive, e në të njëjtën kohë një ndërtimi i sistemi paralel me pasoja të qarta për nxënësit që kryejnë sjellje të papërshtatshme.**

Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive janë një model për disiplinimin e sjelljes në të cilin theksohet vetëkontrolli dhe këmbëngulja e të rriturit, jo kontrolli i fëmijës.



Synimi i kësaj qasjeje është t' u mësohen nxënësve SJELLJE ZËVENDËSUESE, apo ato **që duhet të bëjnë në vend të sjelljes së papërshtatshme, në mënyrë që të gjithë nxënësit të mësojnë në një mjedis arsimor që është si i sigurt**, i këndshëm e joshqetësues, gjë që u lejon nxënësve të arrijnë maksimumin e potencialit të tyre për të mësuar.

Nëpërmjet Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive, mësuesit u mësojnë nxënësve se çfarë pritet konkretisht prej sjelljes së tyre. Këto pritshmëri i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë si të sillen në klasë, korridor, në oborr e çdo vend tjetër në shkollë. Kur nxënësit sillen pozitivisht, mësuesit trajnohen të gjejnë format e duhura që të miratojnë dhe vlerësojnë sjelljen pozitive të nxënësve. Ky vlerësim i inkurajon nxënësit të vazhdojnë të veprojnë pozitivisht.

Falë tyre, në vend që shkolla të përpiqet të gjejë zgjidhje afatshkurtra për nxënës të caktuar që thyejnë rregullat, fokusohet në gjetjen e rrugëve që ndihmojnë nxënësit të mësojnë dhe ruajnë sjelljet e përshtatshme në shkollë.

Në fokusin kryesor të Ndërhyrjeve për Sjelljet Pozitive është krijimi i një sistemi të qartë për sjelljet e dëshiruara dhe që priten nga çdo individ në shkollën tuaj. Edhe pse secili nga ne mund të ketë hamendësimet e veta për atë që mund të quhet sjellje e përshtatshme në shkollë, ne nuk mund të jemi të sigurt nëse këto hamendësime janë njësoj te të gjithë. Nëpërmjet Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive ne do të punojmë për të krijuar dhe ruajtur një mjedis të sigurt dhe produktiv, në të cilin i gjithë komuniteti shkollor ka pritshmëri dhe kuptim të qartë e të njëjtë të rolit të tyre në krijimin e këtij mjedisi dhe të procesit mësimor.

## Parimet mbi të cilat bazohen Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive

### Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive frymëzohen nga disa parime bazë:

1. Dinjiteti i çdo individi është e drejtë themelore e tij. Respekti, siguria dhe përgjegjshmëria janë disa nga parimet bazë, mbi të cilat ndërtohen marrëdhëniet e shëndetshme që lejojnë rritjen dhe zhvillimin e çdo individi në potencialin e tij të plotë.
2. Nxënësit janë përgjegjës për veten dhe sjelljen e tyre. Ata kanë potencialin të menaxhojnë veten, nëse ndihmohen të zhvillojnë aftësitë e nevojshme.
3. Fokusimi në anët pozitive të nxënësve dhe përdorimi i strategjive jondëshkuese e që respektojnë fëmijët, mund të çojë në motivimin dhe përvetësimin më të mirë të sjelljeve të përshtatshme.
4. Fokusimi te parandalimi, mësimi e modelimi dhe inkuarjimi i sjelljeve të pritshme duhet të predominojë në raport me trajtimin.

### Çfarë nuk janë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive?

Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive nuk janë një formë e re për të llastuar apo manipuluar fëmijët e të rinjtë. Ato nuk kanë në qendër të tyre shpërblimin dhe pasojat, por besimin reciprok tek njëri-tjetri në shkollë. Ato nuk janë një qasje e re që u jep mundësi mësuesve “të mbajnë me hatër disa” e “të kenë me sy të keq” disa të tjerë.



Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive nuk janë disa fletë me rregulla të vendosura bukur në çdo mur të shkollës. Ato nuk janë as aktivitete, që kryhen vetëm për një periudhë kohe. Thelbi i tyre nuk është shpërblimi i sjelljeve pozitive të përcaktuara nga tre l-të, por inkurajim i sjelljeve që respektojnë dinjitetin e çdo individi në shkollë dhe dekurajimin e çdo sjelljeje që bën të kundërtën. Vlera e vërtetë e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive nuk qëndron te forma, por te përmbajtja. Kjo do të thotë se gjithkush në shkollë merr dhe bën pjesën e vet të përgjegjësisë për të nxitur respektin për veten dhe tjetrin.

Së fundmi, Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive nuk janë një formë e zgjidhjes së konfliktit me mënyrën “Ose unë, ose ti në këtë shkollë”. Ato e vendosin menaxhimin e sjelljes në duart e ekipeve dhe të rriturve të qetë që së pari dinë të jenë një model pozitiv për fëmijën dhe dinë ta respektojnë atë, edhe kur fëmija sillet në mënyrë të papërshtatshme, edhe pse bashkë me të hedhin hapat për ndryshimin e kësaj sjelljeje.

**Në shkollat ku zbatohen Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive, nxënësit shprehen se ato u kanë sjellë shumë përfitime. Më konkretisht ata shprehen se në shkollat e tyre:**

1. Është rritur numri i nxënësve që vijnë çdo ditë në shkollë
2. Mjedisi i shkollës është më i qetë dhe i këndshëm
3. Mësuesit sillen më profesionalisht dhe më me etikë
4. Ka pakësim të sjelljeve shqetësuese nga nxënësit me probleme në sjellje
5. Ka pakësim të sjelljeve negative në të gjithë shkollën



## Pse mendojmë se Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive do të jenë efektive në shkollën tuaj?

Në përgjithësi, shkollat investojnë shumë energji dhe kohë duke u përqendruar në disiplinimin e nxënësve, që nuk sillen pozitivisht. Synimi i NSP-së është t' u mësojë jo vetëm nxënësve, por të gjithë komunitetit të shkollës se çfarë sjelljesh priten prej tyre, njësoj siç mësohen lëndët e tjera në shkollë. Studimet kanë gjetur se ndonjëherë, kur një nxënës sillt negativisht, kjo ndodh sepse ai/a jo nuk i kupton pritshmëritë për sjelljen e tij. Pikërisht këtë gjë bëjnë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive. Ato shpjegojnë në mënyrë të qartë e të thjeshtë se çfarë mund e nuk mund të ndodhë në shkollë. Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive nuk fokusohen në ndëshkimin e sjelljeve negative, por në parandalimin e tyre dhe bëjnë të mundur që nxënësit të kuptojnë si të sillen, duke mbështetur dhe aprovuar sjelljet e pritshme.

Studimet tregojnë, gjithashtu, se ato shkolla që e përdorin këtë qasje, kanë atmosferë më të këndshme dhe mikpritëse për nxënësit dhe familjet. Me anë të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive nxënësit kalojnë më shumë kohë në klasë. Shkollat që e kanë përdorur këtë qasje kanë reduktuar nivelin e braktisjes së shkollës, si dhe kanë pjesëmarrje më të lartë në shkollë e arritje më të larta akademike. Kjo qasje ndihmon në të njëjtën kohë edhe mësuesit. Falë kësaj qasjeje, mësuesit nuk do ta kenë të nevojshme të shpenzojnë kohë në disiplinimin e nxënësve, por mund ta shfrytëzojnë kohën në funksion të mësimdhënies, gjë që çon drejt mbarëvajtjen më të lartë të nxënësve.

**Ndërhyrjet për Sjelljet Pozitive janë një qasje që i ndihmon nxënësit të jenë të suksesshëm në shkollë. NSP-të janë hartuar falë studimeve të shumta shkencore në fushën e teorisë së sjelljes dhe udhëzimit efektiv. Njëpërmjet kësaj qasjeje sjelljet e padëshiruara zëvendësohen me sjellje dhe aftësi të reja të përshtatshme. Në zemër të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive është mësimi i aftësive të përshtatshme dhe shpërblimi i sjelljes së përshtatshme. Ndërhyrjet për sjellje pozitive mbështesin të gjithë nxënësit, jo vetëm ata që paraqesin probleme të ndryshme në sjellje. E thënë ndryshe, fokusi kalon nga reagimi të parandalimi i sjelljeve të papërshtatshme.**



## Cilët janë disa elementët thelbësorë në zbatimin e NSP-ve?

Prindërit dhe nxënësit konsiderohen partnerët më të rëndësishëm në zbatimin e programit të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive. Në tabelën e mëposhtme kemi renditur disa nga elementët kryesorë të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive.

### Elementët e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në nivel shkolle:

- qasje e përbashkët për disiplinën, për të cilën kanë rënë dakord të gjithë në shkollë
- d pozitive për qëllimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive
- përcaktim i sjelljeve të pritshme të shprehura me gjuhë pozitive për të gjithë: nxënësit, stafin dhe familjet
- procedura për t'u mësuar nxënësve sjelljet e pritshme
- procedura për të inkurajuar nxënësit të zgjedhin sjellje që përmbushin pritshmëritë
- procedura për të shkurajuar nxënësit që duan të zgjedhin sjellje që thyejnë rregullat
- procedura për monitorimin e rregullt të efektivitetit të sistemit të disiplinës

## Si funksionojnë në praktikë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive?

Një ekip specialistësh krijon një kurrikul për sjelljen, e cila që rregullat e shprehura me gjuhë pozitive dhe që mund të mbahen mend lehtë. Këto rregulla zbatohen **në të gjitha** mjediset e shkollës dhe duhet të ndiqen gjatë tërë kohës së qëndrimit në shkollë. Nëse ndiqen këto rregulla dhe procedura, atëherë stafi mësimor gjen mënyra për të shpërblyer çdo individ, klasë apo nxënës ose të gjithë shkollën.



Rregullat dhe pritshmëritë bazohen në tri parime universale për sjelljen. Këto parime drejtuese dhe frymëzuese të rregullave të përzgjedhura janë ato që gjerësisht do të njihen si tri I-të: I sigurtë, i respektueshëm dhe i përgjegjshëm. Mënyra si do të zbërthehen këto tri parime universale në çdo mjedis të shkollës është një proces që përfshin jo vetëm mësuesit dhe nxënësit, por edhe prindërit e komunitetin. Përmes këtij procesi përcaktohen rregullat dhe normat për secilin parim në vende të ndryshme të shkollës, sic është pasqyruar në modelin e mëposhtëm:<sup>2</sup>

*Bazuar në shembullin e dhënë, përpuni të hartoni rregullat edhe në mjediset e tjera të shkollës, siç janë korridori, tualetet dhe oborri i shkollës.*

3 I-të	Në klasë	Në korridor	Në tualete	Në oborr
I sigurtë	Ngrini dorën për të folur! Shmangni përdorimin e gjuhës së papërshtatshme! Dëgjoni me respekt! Flisni me edukatë Respektoni pronën e shkollës! Mbajeni klasën të pastër dhe të rregullt!			



i respektueshëm	Ejani në kohë në klasë! Mbahini shënim detyrat e shtëpisë! Ndiqni udhëzimet e mësuesit! Plotësoni detyrat e përditshme! Pranojini pasojat e sjelljeve negative, pa diskutuar ato!			
i përgjegjshëm	Mbahini mjetet shkollore për vete! Rrini në vendin e paracaktuar! Ndiqni procedurat e sigurisë në zona të veçanta dhe daljet e emergjencës!			

Sipas qasjes së Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive, çdo shkollë duhet të ketë metodat e veta për të inkurajuar sjelljet pozitive të nxënësve. Përcaktimi i qartë i sjelljeve specifike që priten nga nxënësit është mjaft i rëndësishëm për të rritur mundësitë për rishfaqjen e sjelljeve të përshtatshme.

Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive-të në disa raste mund të zbatohen si për arritjet akademike të nxënësit, ashtu edhe për sjelljet sociale të tij. Ky kuadër u jep mundësi të gjithë nxënësve në mjediset e shkollës të jenë të ekspozuar ndaj praktikave më efektive dhe të përshtatshme të udhëzimit të sjelljes. Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive nuk janë program mësimor, por një kuadër që të ndihmon të marrësh vendime në të mirë të sjelljes pozitive. Idetë e përfshira te Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive janë shumë fleksibël, ndaj dhe zbatimi i rregullave dhe i programeve në çdo shkollë mund të ndryshojë, ndonëse rezultatet mbeten të njëjta,



### Po cilat janë, konkretisht, rregullat që u mësohen nxënësve të shkollës përmes Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive?

Në shumicën e rasteve pritshmëritë zgjidhen së bashku me nxënësit. Siç vihet re në matricën e mësipërme, pritshmëritë janë sjellje të thjeshta të tilla si: si të ecni të sigurt në korridore apo në raste të tjera si të zgjidhni një debat me një shok kur jeni në oborrin e shkollës. Megjithatë pritshmëritë nuk kanë të bëjnë vetëm me mësimin e rregullave. Ajo që është thelbësore te NSP-të është se në zbatimin e tyre shkollat punojnë së bashku me nxënësit në mënyrë të tillë që nxënësit të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për t'u përgjigjur në situata të ndryshme përmes rrugëve pozitive dhe produktive. Kjo gjë mund t'i ndihmojë nxënësit jo vetëm në shkollë por edhe në jetë.

Me NSP-të, të gjithë nxënësit marrin mësim për sjelljen dhe aftësitë pro sociale. Për ata nxënës që kanë nevojë për më shumë trajnim dhe mbështetje ose ndërhyrje, shkolla ua mundëson duke koordinuar me shërbime të tjera. Është e nevojshme që çdo sjellje dhe pritshmëri t'u mësohet nxënësve, sepse të dhënat tregojnë se kur shkollat marrin kohën e nevojshme për t'u shpjeguar nxënësve si dhe pse duhet të sillen në një mënyrë të caktuar e u mësojnë aftësitë e nevojshme për t'u zhvilluar, ata i inkurajojnë këto sjellje të nxënësit e tyre. Të njëjtat studime tregojnë se kur shkollat i mbështesin dhe vlerësojnë këto sjellje pozitive, nxënësit i përsërisin ato.

### Çfarë ndodh nëse nxënësit nuk zbatojnë normat/rregullat/pritshmëritë e vendosura së bashku?

Edhe pse NSP-të janë hartuar për të gjithë nxënësit ato janë ndërtuar në një sistem me tri nivele. Çdo nivel bëhet më intensiv në termat e menaxhimit dhe planeve të individualizuara të sjelljes. Kur nxënësit nuk sillen në mënyrë të përshtatshme, atëherë ekipi që do të ndërtohet në shkollë për të mbështetur dhe ndërhyrë me nxënës të cilët nuk ndjekin rregullat e vendosura së bashku do të ndihmojë në mënyrë më specifike këta nxënës. Ndërhyrjet dhe mbështetjet për këta nxënës janë programe dhe ndërhyrje të metejshme që mund t'i ndihmojnë të mësojnë dhe të rriten. Shumica e nxënësve ja dalin

mirë përmes trajnimit me NSP-të. Megjithatë disa nxënës kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme. Stafi i shkollës do të përpiqet të punojë për të kuptuar pse ndodh kjo gjë. Ndonjëherë nxënësit thjesht nuk kanë kuptuar pritshmëritë. Në këto raste, stafi i shkollës do të punojë me ta për t'u siguruar që ata t'i kuptojnë pritshmëritë.

Në raste të tjera, nxënësit kanë nevojë për më shumë aftësi për të qenë në gjendje të bëjnë më të mirën në klasë. Stafi i shkollës do të punojë të realizojë këto ndërhyrje e për t'u mësuar aftësitë e munguara. Në disa raste, një nxënës mund të ketë nevojë edhe për më shumë mbështetje që t'ia dalë mbanë, ndaj në këtë rast shkolla mund të kërkojë ndihmën e shërbimeve të tjera në zonë për t'i ofruar mbështetje nxënësit.

Në disa raste, një nxënës ka vështirësi me sjelljen. Në raste të tjera nuk është e qartë cili është shkaku i problemeve në sjellje. Me anë të NSP-ve nxënësit vlerësohen për të parë se si po shkojnë me sjelljen. Vlerësimi në këtë rast ndihmon në identifikimin e të gjithë nxënësve që po hasin vështirësi me sjelljen, gjë që bën të mundur t'u jepet ndihma dhe ndërhyrjet, për të cilat kanë nevojë.





## KAPITULLI I I DYTË

### PËRFSHIRJA E NXËNËSVE NË ZBATIMIN E METODOLOGJISË SË NDËRHYRJEVE PËR SJELLJE POZITIVE DHE KRIJIMIN E KLIMËS POZITIVE NË SHKOLLË

Neni 12 i Konventës së të Drejtave të Fëmijëve thekson të drejtën e çdo fëmije për të shprehur opinionin e tij në çdo rast kur të rriturit marrin vendime, që mund të ndikojnë jetën e tij. Në Shqipëri, ky nen ka nxitur atë që quhet “zëri i fëmijëve”. Vlera e zërit tuaj si nxënës në shkollë është e veçantë, sepse ju keni perspektiva shumë unike në jetën e shkollës, të cilat të rriturit duhet t’i dëgjojnë dhe të përgjigjen pozitivisht.

Çdo individ i përfshirë ka rol të rëndësishëm në krijimin e një klime miqësore e të sigurtë në shkollë. Për këtë arsye, një ndër kriteret e shkollave cilësore është edhe përfshirja reale e nxënësve në çdo aspekt të jetës së shkollës. Në këtë kapitull të udhëzuesit kemi ndarë me ju sugjerime praktike për format dhe mënyrat e përfshirjes në shkollën tuaj në hartimin dhe zbatimin e metodologjisë së Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive. Programi i Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive do të ketë ndikim të dukshëm në jetën e përditshme të shkollës, vetëm nëse ju do të luani rol aktiv e të drejtpërdrejtë në zbatimin e tyre.



## Sa i rëndësishëm dhe i dobishëm mund të jetë angazhimi juaj si nxënës

Studimet tregojnë se angazhimi dhe motivimi juaj për të marrë pjesë në jetën e shkollës bazohet në besim dhe përvojat e kënaqshme. Edhe pse është stafi i shkollës, që duhet t'u mundësojë nxënësve role të përshtatshme në realizimin e projekteve në shkollë, ju nuk e keni gjithmonë të qartë si të përfshiheni në këto angazhime.

Përfshirja dhe angazhimi juaj kërkon që të jeni e të veproni të fokusuar, gjë që ju lejon të mësoni se cili është potenciali i roleve tuaja individuale dhe në grup. Për ju është e nevojshme të përfshiheni në aktivitete dhe përgjegjësi të përshtatshme me nivelin tuaj të zhvillimit, në mënyrë që të rrisni kapacitetin tuaj për pjesëmarrje edhe më të fuqishme në vitet e ardhshme. Përfshirja dhe angazhimi juaj real në procesin e hartimit dhe zbatimit të planit për Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive është mënyra më e mirë për t'u siguruar se gjithkush është informuar dhe ka marrë përgjegjësitë përkatëse në shkollën tuaj.

Mos harroni se angazhimi juaj i vërtetë shfaqet atëherë kur të rriturit nuk kanë ide të paramenduara e janë të gatshëm të dëgjojnë e të përgjigjen. Kjo gjë ndodh kur ka besim dhe vendimmarrje të përbashkët. Shkollat duhet të kërkojnë role me vlera të vërteta, që nxisin kontribute të rëndësishme të nxënësve, kua ata dëgjojnë vërtet dhe vlerësohen.





Shihni me kujdes tabelën e mëposhtme. Në çfarë niveli e vlerësoni angazhimin tuaj në jetën dhe aktivitetet e shkollës?

Është e qartë se angazhimi juaj si nxënës në shkollë është më i plotë e domethënës në rrathët më të mbushur.

Modeli i mëposhtëm tregon 5 nivelet e angazhimit të nxënësve në shkollë



Nxënësve u jepen detyra nga stafi mësimor, që të angazhohen në shkollë



Nxënësit konsultohen nga stafi i shkollës për angazhimet që marrin në shkollë



Nxënësit dhe stafi janë të barabartë



Nxënësit angazhohen dhe i drejtojnë vetë aktivitetet e ndërmarra vullnetarisht në shkollë



Nxënësit dhe mësuesit kanë përgjegjësi të përbashkët për aktivitetet në shkollë





## Sa e rëndësishme është përvoja juaj në përfshirjen dhe angazhimin në aktivitetet e shkollës?

Në tabelën e mëposhtme, e cila ka si qëllim jo vetëm vetëvlerësimin për cilësinë e angazhimit tuaj në shkollë, por edhe të dallojë thellësinë dhe mundësitë për ta kthyer angazhimin tuaj në shkollë në një përvojë kuptimplotë për ju, ne kemi krahasuar disa nga karakteristikat dalluese të angazhimit të nxënësve kur ai është kuptimplotë ose jo i tillë.

**Tabela: Krahasoni angazhimin domethënës me ato jo domethënës**

Kur përvoja juaj si nxënës në angazhimet shkollore mund të konsiderohet domethënëse në rastet kur:	Kur përvoja juaj si nxënës në angazhimet shkollore NUK mund të konsiderohet domethënëse në rastet kur:
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Nxënësit janë aleatë dhe partnerë me të rriturit në përmirësimin e shkollës.</li> <li>✓ Nxënësit kanë trajnimin dhe autoritetin e nevojshëm për të dhënë zgjidhje reale ndaj çdo sfide që has shkolla.</li> <li>✓ Shkolla, përfshirë stafin mësimor dhe drejtuesin e shkollës, është e përgjegjshme ndaj nxënësve.</li> <li>✓ Partneriteti mes nxënësve dhe të rriturve është element thelbësor në çdo qasje të re për të transformuar shkollën.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Nxënësit shihen si marrës pasivë të përgjegjësive ose si enë bosh që duhen mbushur përmes dijes që përcillet nga mësuesit.</li> <li>✓ Kontributi i nxënësve minimizohet apo shpërblehet nga të rriturit, ose kur janë pjesë e komiteteve a organizimeve pa pushtet apo përgjegjësi reale.</li> <li>✓ Qasjet, perspektivat dhe përvojat e nxënësve filtrohen me interpretime nga ana e të rriturve.</li> <li>✓ Kur nxënësve u jepen probleme për zgjidhje por pa mbështetjen dhe trajnimin e duhur ose kur ata trajnohen për role drejtuese por nuk u janë mundësi reale për të zbatuar këto role në shkollën e tyre.</li> </ul>



Për të kuptuar qartë mundësitë dhe rolet tuaja në krijimin e një klime pozitive dhe respektuese në shkollë, mes shumë modeleve, ne kemi përzgjedhur t'ju prezantojmë modelin e gjashtë roleve të angazhimit të nxënësve në shkollë, me qëllimin të kuptoni se sa e gjerë është fusha dhe rolet ku mund të merrni përsipër në zbatimin e programit të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive.

Nisur nga diagrami i mësipërm për rolet tuaja në përfshirjen dhe angazhimin në shkollë, në tabelën e mëposhtme kemi dhënë ide dhe sugjerime të ndryshme sesi mund të përfshihen në aktivitete të ndryshme në ndihmë të reallizimit të qasjes së NSP-ve në shkollën tuaj. Sigurisht këto janë vetëm disa ide fillestare, të cilat mund t'i zgjeroni ose të mendoni për aktivitete të tjera të ngjashme që janë më të përshtatshme për ju në shkollën tuaj.

### Modeli me gjashtë role i angazhimit të nxënësve në shkollë






Tabela: Roli juaj sipas moshës në hartimin dhe zbatimin e Ndërhryjeve për Sjellje Pozitive

Roli	Nxënësit nga klasa e parë në klasën e pestë	Nxënësit nga klasa e gjashtë në klasën e nëntë
<b>Planifikues</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Planifikoni bashkë me mësuesin kujdestar aktivitete në nivel klase për t' unjohur me qasjen e re dhe rregullat e Ndërhryjeve për Sjellje Pozitive</li> <li>✓ Mendoni për mënyra që nxisin respektin, sigurinë dhe përgjegjshmërinë në shkollë e në zonën kubanoni.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Bëhuni anëtar i ekipeve të Ndërhryjeve për Sjellje Pozitive, si dhe i ekipeve për zgjidhjen e konflikteve në shkollë.</li> <li>✓ Planifikoni aktivitete që nxisin sigurinë dhe klimën pozitive në shkollë.</li> <li>✓ Mendoni për forma sesi shkolla mund të bashkëpunojë me komunitetin për të dhënë mesazhet: “Ji i sigurt” “Ji i respektueshëm” “Ji i përgjegjshëm” në mënyrë të bashkërenduar.</li> </ul>



<b>Kërkues shkencor</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Anketoni familjarët tuaj, për mënyrën se si ata i kuptojnë tema të tilla si: disiplina pozitive, dhuna, mesazhet e Ndërhryrjeve për Sjellje Pozitive.</li><li>✓ Pyesni nxënësit nga klasa të tjera të vizatojnë idetë e tyre për mesazhet e NSP-ve dhe si e mendojnë ata një shkollë të sigurtë, respektuese e mbështetëse.</li><li>✓ Mblidhni informacion nga vizatimet e nxënësve për mesazhet e NSP-ve dhe shkollave të sigurta, respektuese e mbështetëse.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Anketoni nxënësit dhe familjet sesi ata kuptojnë tema të tilla, si: mesazhet e Ndërhryrjeve për Sjellje Pozitive, disiplina ndaj fëmijëve në shkollë dhe familje, dhuna etj si dhe format e parandalimit të sjelljeve negative të fëmijët.</li><li>✓ Mblidhni informacion për mënyrën se si i shohin nxënësit në shkollë Ndërhryrjet për Sjellje Pozitive, bullizmin, mënyrat e disiplinimit dhe trajtimit të sjelljeve të papërshtatshme në shkollë.</li><li>✓ Pyesni nxënësit të tjerë si është të ndihen të sigurtë në shkollë dhe se çfarë mund të bëhet për të mundësuar sigurinë në shkollë.</li></ul>
-------------------------	--	--



<b>Mësues</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Organizoni “lojë me role” për format e sjelljes pozitive në situata të ndryshme sociale në shkollë.</li> <li>✓ Në lojën me role përqendrohuni në modelimin e sjelljeve të përshtatshme në çdo vend të shkollës, siç është detajuar në modelin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive.</li> <li>✓ Shpjegojuni nxënësve të rinj në shkollë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive dhe -të dhe zbatimin e rregullave.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Mësojuni nxënësve më të vegjël për NSP-të dhe ndërhyrjet e nivelit të parë të NSP-ve.</li> <li>✓ Mësojuni si të reagojnë dhe si të zgjidhin situata ngacmimi, si të raportojnë dhunën ndaj tyre etj.</li> <li>✓ Drejtoni sesione edukative për nxënësit e rinj dhe familjet lidhur me Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive, format e mbrojtjes nga dhuna dhe bullizmi etj.</li> </ul>
<b>Vlerësues</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Diskutoni dhe vlerësoni sjelljen e personazheve të ndryshme në tekstet shkollore sidomos sesi ata kanë reaguar në situata të ndryshme sociale. (në situata dhune ndaj tyre, bullizëm, etj.)</li> <li>✓ Reflektoni dhe vlerësoni përgjigjet e mundshme të nxënësve në lojën me role për situata të ndryshme sociale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Diskutoni dhe vlerësoni mbi personazhe nga libra të ndryshëm të lexuar dhe mënyrën e sjelljes së tyre në situata të ndryshme sociale.</li> <li>✓ Mblidhni të dhëna përmes intervistave për të vlerësuar efektivitetin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive dhe nivelin e zbatimit të tyre në shkollën tuaj.</li> </ul>
<b>Vendimarrës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Vendosni si të krijoni një mesazh që lidhet me zbatimin e tri “i”-ve dhe mënyrën e shfaqjes së tyre në aktivitete kundër dhunës, bullizmit dhe diskriminimit në shkollë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Vendosni si të organizoni aktivitete në ditë të caktuara (Ditën Kundër Dhunës, Bullizmit, Ditën kundër Diskriminimit, Ditën e Konventës së të Drejtave të Fëmijëve etj. kundër dhunës, bullizmit dhe diskriminimit, Ditën e Konventës së të Drejtave të Fëmijëve etj.)</li> </ul>



<b>Advokues</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Përdorni takime të rregullta të klasës për të diskutuar dhe ngritur çështje të ndryshme që lidhen me sigurinë dhe krijimin e mjedisve të sigurta në shkollë.</li><li>✓ Kontribuoni në asamblatë apo përmes qeverisë së nxënësve me ide dhe strategji për krijimin e mjedisve respektuese dhe tolerante në shkollë.</li><li>✓ Drejtoni një diskutim me nxënësit për mënyrën si e duan ata shkollën. (p.sh. imagjinoni një shkollë pa dhunë).</li><li>✓ Ndihmoni në firmosjen e kontratës së përbashkët në shkollë për zbatimin e rregullave të vendosura së bashku.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Drejtoni një fushatë promovuese për hartimin e një plani për parandalimin e dhunës në shkollë dhe promovimin e NSP-ve.</li><li>✓ Jepni kontributin tuaj në realizimin e një udhëzuesi për zbatimin e rregullave dhe procedurave në shkollë, hartimin e posterave, broshurave dhe fletëpalosjeve dhe materialeve të tjerapër tri “I” të dhe strategjitë e ndërhyrjes për sjelljet pozitive.</li><li>✓ Diskutoni me nxënësit e tjerë se si e duan shkollën në të ardhmen,</li><li>✓ Aplikoni në qeveritë e nxënësve dhe bashkëpunoni me qeverinë e nxënësve në krijimin e një shkolle më të sigurtë dhe zbatimin e strategjive të NSP-ve.</li><li>✓ Dizenjoni një fushatë për krijimin e një shkolle të sigurt.</li></ul>
-----------------	--	---

*Përpara se të përdorni secilin prej këtyre aktiviteteve, mendoni sa të përshtatshme janë ato në kontekstin e shkollës suaj. SHqyrtoni me kujdes rreziqet që lidhen me konfidencialitetin e informacionit personal dhe gjeni strategji të përshtatshme për ruajtjen e të dhënave.*



Nisur nga përvoja të ngjashme ndërkombëtare të cilat e zbatojnë prej vitesh modelin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive, ne sugjerojmë, në vijim, edhe disa strategji e rrugë të reja, që mund t'i merrni në konsideratë për të dhënë kontributin tuaj vullnetar në krijimin e një klime më pozitive e të sigurt në shkollë.

- ✓ Përdorni teknologjinë dhe rrjetet sociale për të ndarë informacion mbi nismat që ndërmerrni, praktikat pozitive, mesazhet kryesore të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive etj. Teknologjia dhe rrjetet sociale janë një formë e thjeshtë e me ndikim të lartë të nxënësit. Mund të kontribuoni edhe me ide e sugjerime në platformën që do të ngrihet për promovimin e tri "I"-ve. Platforma për programin e ri në rrjetet sociale ose në internet do t'u ofrojë publikut dhe medias, si dhe mësuesve e administratorëve të shkollave, një burim informacioni të saktë, koherent dhe të arritshëm për modelin e "tri I-ve" dhe rëndësishnë e këtij modeli për krijimin e kulturës pozitive në shkollë.
- ✓ Merrni pjesë në promovimin me forma të ndryshme të mesazheve të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në shkollë dhe komunitet sip. sh. krijimin e këngëve dhe teksteve, posterave dhe mjeteve të tjera promovuese dhe reklamuese. Përpiquni të shpërndani dhe vendosni në vende të dukshme në shkollë postera dhe forma të tjera të ngjashme të tri I-ve (I sigurtë, I respektueshëm, I përgjegjshëm).
- ✓ Planifikoni emisione televizive në median lokale të qytetit ku banoni ku të promovoni mesazhet e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive.
- ✓ Merrni pjesë në zgjedhjen e shpërblimeve më efikase për nxënësit që sillen pozitivisht (si p.sh. simbole, ngjithëse, privilegje, dhurata simbolike apo edhe ide për shpërblimin e të gjithë klasës apo shkollës (p.sh. ekskursion i veçantë).
- ✓ Plotësoni rregullisht formularët për klimën në shkollë për të vlerësuar suksesin e modelit të kulturës pozitive dhe nxisni bashkëmoshatarët të veprojnë si ju.

- ✓ Qeveria e nxënësve, si organizëm i rëndësishëm përfaqësues i nxënësve, në shkollë mund të luajë një rol aktiv e të ndihmojë në këtë proces përmes informimit të të gjithë nxënësve për çështjet kryesore në shkollë por edhe duke i ofruar mundësi çdo nxënësi të shprehë mendimet, dëshirat dhe idetë e veta. Qeveria e shkollës mund të ketë një mekanizëm të rregullt për të raportuar te trupa e nxënësve, përmes të cilit nxënësit e tjerë të kontribuojnë me ide dhe komente për shkollën.
- ✓ Krijoni projektin tuaj kundër dhunës në shkollë.
- ✓ Ndërtoni grupe këshillimi për të ndihmuar që viktimat e dhunës dhe të bullizmit të gjejnë mbështetje.
- ✓ Merrni pjesë dhe trajtohuni për t'u bërë ndërmjetësues që të mund të ndihmoni në rast mosmarrëveshjesh apo konfliktesh.
- ✓ Bëjini ju realitet Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive në klasë, oborr, komunitet. Bëhuni ju ata që sjellin të parët ndryshimin.
- ✓ Krijoni klube, qendra brenda shkollës, të cilat të mund të drejtohen nga ju. Në këto qendra nxënësit mund të gjejnë informacion për tema të rëndësishme. Në informacion mund të përfshihen përveç librave dhe broshurave edhe filma që prekin tema që lidhen me Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive, reduktimin e dhunës, menaxhimin e zemërimit, përvetësimin e aftësive sociale etj. Këto qendra mund të ofrojnë këshillim për nxënësit nga vetë nxënësit.
- ✓ Merrni pjesë në hartimin dhe zbatimin e rregullave të shkollës.<sup>3</sup>
- ✓ Ndërgjegjësoni të tjerët duket përdorur forma të larmishme si: forumet, prezantimet me anë të videove të krijuara nga ju, koncerteve, etj.

<sup>3</sup> Në shtojcë kemi dhënë një model aktiviteti për pjesëmarrje në krijimin e rregullave në shkollë.







## KAPITULLI I TRETË

### Roli i prindërve në zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive

Rolin tuaj si prindër në zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive e shohim në dy forma kryesore: në zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në shtëpinë tuaj si dhe në bashkëpunimin me shkollën për të mbështetur shkollën në zbatimin e tyre.

Fillimisht do t'ju prezantojmë informacionin kyç dhe praktik për mënyrat dhe hapat për t'i testuar Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive në shtëpi. Në vijë, do t'ju njohim me informacione dhe ide për format e bashkëpunimit me shkollën e fëmijës së në zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive.

### Si mund t'i zbatoni Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive në shtëpi?

Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive nuk janë vetëm për shkollat. Prindërit mund të përdorin të njëjtat ide për të krijuar mjedise më të shëndetshme për të gjithë familjen. Studimet shkencore tregojnë se, kur pritshmëritë e prindërve përcaktohen në bashkëpunim me fëmijën, dhe më pas i mësohen atij në shtëpi, sjelljet problematike mund të parandalohen ose të pakësohen. Nëse ky model funksionon në shkollë, sigurisht që mund funksionojë edhe në shtëpi.



**Hapat kryesorë për të vendosur Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive në familje.**

1. Vendosni pritshmëri të qarta
2. Bëni një mbledhje familjare
3. Përdorni përforcimin pozitiv për sjelljet e përshtatshme
4. Përdorni pasojat për sjelljet problematike.

**Le të shohim dhe të qartësojmë secilin nga hapat e mësipërm:**

*Hapi i parë - Pritshmëri të qarta*

1. Krijoni një model për sjelljen, i cili ju ndihmon të përzgjidhni sjelljet e dëshiruara gjatë rutinave kryesore të fëmijës në shtëpi, sikurse shembulli që kemi sugjeruar më poshtë.
2. Përdorni 3 I-të që fëmija ka mësuar në shkollë edhe në shtëpi
  - a. I sigurt
  - b. I respektueshëm
  - c. I përgjegjshëm

Shembull se si mund të ndërtohet ky model:

Pritshmëritë	Zgjidhimi në mëngjes	Rruga për në shkollë	Bërja e punëve të mia	Koha e argëtimit së bashku	Koha e detyrave të shtëpisë	Koha /Vaktet e ushqyerjes	Përgatitja për të fjetur
<b>I sigurt</b>		Pres makinën/ autobusin në stacion				Tregohem i kujdesshëm me thikat, gotat ose pjatat e nxehta;	
<b>I respektueshëm</b>	Nuk qëndroj gjatë në tualet, në mënyrë që ta përdorin dhe të tjerët.			Tregoj korrektësi		Dëgjoj ndërsa të tjerët flasin	Shkoj në shtrat në kohën e përcaktuar
<b>I përgjegjshëm</b>	Çoj në lavaman pjatat, me të cilat kam ngrënë mëngjesin	Nisem në kohë, në mënyrë që të arrij në shkollë në orën e caktuar.	Ndjek listën e detyrave që kam për të bërë gjatë ditës.	Largoj ato që pengojnë rrugën.	Bëj gati çantën që ta kem në rregull për ditën e nesërme.	Ndihmoj në pas-trimin e tavolinës	Gjej rrobat që më duhen për të nesërmen.
<p><b>Nuk është e thënë të mbushni çdo kuti të tabelës. Zgjidhni vetëm ato më thelbësoret për familjen tuaj.</b></p>							



### *Hapi i dytë - Mbledhja Familjare*

Do të ishte mirë të bënit një mbledhje familjare, për të bërë të njohur modelin. Për të treguar matricën në shtëpi. Shpjegoni sjelljet që priten (është mirë ta ndërtoni modelin bashkë me fëmijën, por nuk ju duhet domosdoshmërisht aprovimi i tij. Jeni ju i rrituri!). Fillimisht demonstroi vetë sjelljen që dëshironi nga fëmija. Përdorni lojën me role dhe praktikoni disa herë sjelljen e dëshiruar. Më pas shpjegojini përforsimet pozitive dhe pasojat nëse nuk kryhet sjellja.

### *Hapi i tretë - Përforsimi Pozitiv*

Përforsimi pozitiv nënkupton t'i japësh diçka fëmijës, kur ai kryen veprimin e dëshiruar, në mënyrë që ai ta lidhë veprimin e kryer me shpërblimin që merr për ta nxitur kështu që ta bëjë sërish atë veprim. Shpërbilimi në këtë rast është stimuli përforsues. Nëse jepet në kohën, formën dhe mënyrën e duhur, përforsimi pozitiv është një ndër elementët më të rëndësishëm në modelin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive. Ndaj është me rëndësi që përforsimi pozitiv të jetë i vazhdueshëm për të gjitha sjelljet e dëshiruara.

#### ***Disa ide që mund t'i përdorni si përforsime pozitive:***

*Tabelë me ngjitëse apo pikë:* Për çdo sjellje të dëshiruar fitohet një pikë apo ngjitëse. Në këtë mënyrë fëmija mund të ketë një qëllim e të fitojë shpërblimin për arritjen e rezultatit.

*Mund të përdorni një menu shpërblimesh,* disa të mëdha e disa të vogla, në mënyrë që fëmija të mund të blejë me pikët që fiton.

Mund të keni edhe pikë që fitohen kur arrihet qëllimi nga e gjithë familja “kur të fitojmë 50 pikë si familje ne do të...”.

*Vendosni shpërblime (përforsim pozitiv) pa kosto ose që kanë kosto të vogël për ju.*



Me të drejtë mund të pyesni: a do të na duhet të japim gjithmonë pikë? Në të vërtetë, studimet tregojnë se do t'ju duhet ta bëni për një farë kohe, derisa fëmija ta bëjë rutinë një sjellje të caktuar. Me kalimin e kohës do të shihni se do ju duhet të bëni ndryshime apo rifreskime në sjelljet e dëshiruara. *Por fëmijët nuk duhet të sillen mirë pikërisht se po fitojnë një pikë apo ngjitës.* Sigurisht që jo. Pikët apo ngjitëset janë vetëm sçtimulus. Në fakt, pagesa dhe shpërblimi i vërtetë duhet të jetë marrëdhënia pozitive me ju.

Është e rëndësishme që çdo prind të dijë se shpërblimi më i mirë dhe efikas për të mësuar dhe ruajtur sjelljen pozitive tek fëmija është shpërblimi verbal. Lavdërimi duhet të jetë specifik e të lidhet në mënyrë të qartë me sjelljen që po përforconi.

*P.sh. mund t'i thoni fëmijës: “Më pëlqen që po merr vetë lodrat” në vend të: “Të lumtë”.*

*Apo mund t'i thoni: “Duhet të ndihesh krenar për atë që kanë shkruar mësuesit për ty” në vend të “Jam shumë krenar për atë që kanë shkruar mësuesit”.*

*Mund t'i thoni: “Faleminderit që je i përgjegjshëm dhe e largove biçikletën” në vend të “Të dua shumë kur e largon biçikletën.”*

*Apo “Bëre punë të mirë që i ndoqe udhëzimet kur ishim në dyqan sot.” Por mos shtoni fjali të tipit: “Po pse nuk mund të sillësh kështu çdo ditë?”*

### *Hapi i katërt - Pasojat në shtëpi*

Një pasojë është rezultat i diçkaje që bën fëmija. Ta lejosh fëmijën të përjetojë pasojat e natyrshme apo logjike të veprimeve të tij është një ndër mënyrat sesi ai mëson të jetë i përgjegjshëm. Ndonjëherë fëmija mëson më shumë për të ftohtin kur del në të ftohtë i veshur hollë, sesa kur duke diskutuar vazhdimisht me prindërit për për t'u veshur më trashë.



Kjo është rrjedhojë e natyrshme e veprimit të tij. Një pasojë logjike ndodh kur, si rezultat i veprimit të fëmijës, prindi vendos një pasojë për veprimin e tij. Ato vendosen kryesisht kur veprimi i fëmijës mund të jetë i dëmshëm, së pari, për atë vetë. Duhet të siguroheni që pasojat të jenë të arsyeshme dhe të lidhen me problemin, në mënyrë që të ruajmë respektin për veten dhe fëmijën. Pasoja lidhet ngushtësisht me sjelljen e fëmijës dhe i jep atij një mundësi të mësojë se çfarë ndodh kur nuk sillen siç pritet prej tij. Pasojat nuk janë instrumente për të ndëshkuar apo turpëruar fëmijën. Përkundrazi, ato vendosen me qetësi dhe i japin mundësi fëmijës për ta ndryshuar vetë sjelljen.

*P.sh. mund t'i thoni fëmijës “Nëse e bën rrëmujë dhomën, do ta rregullosh vetë.” Apo “Nëse i bën gjërat rrëmujë, do t'i vendosësh vetë në vend.” Megjithatë kjo nuk duhet ngatërruar me shprehje të tilla si: “Rregulloji me vrap gjërat që bëre rrëmujë!” apo “Edhe këtë herë po t'i rregulloj unë, por herë tjetër bëji vetë”.*

Kur fëmija bën gabim, është shumë e rëndësishme:

- të qëndroni i qetë
- t'i kujtoni fëmijës pritshmëritë për sjelljen e tij
- të rimësoni dhe praktikoni bashkë me fëmijën sjelljen e dëshiruar
- të përdorni pasojat në mënyrë të përshtatshme e në përputhje me gabimin.
- të përcaktoni se cilat do të jenë pasojat për sjelljet problematike të fëmijës.

Është me rëndësi që kur praktikoni modelin e pasojave të keni në konsideratë edhe këto sugjerime:

- Kushtojini sa më pak vëmendje sjelljes së papërshtatshme.
- Kursejeni atë kohë që të flisni me fëmijën kur është në gjendje t'ju dëgjojë.



- Përdorni pasoja që janë në përputhje me moshën e fëmijës dhe lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen negative të shfaqur. P.sh. mund t'i thuash “Kur e lë biçikletën jashtë, nuk të lejohej ta përdorësh nesër”, por nuk mund t'i thuash: “Meqë e le biçikletën jashtë, nuk mund të hash ëmbëlsirë.”

### A do të funksionojë kjo gjë?

Lajmi i mirë është se nxitja e sjelljeve pozitive në shtëpi përmes përdorimit të parimit të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive është provuar se sjell një ndryshim pozitiv në 80% të familjeve. Por lajmi i keq është se jo çdo gjë funksionon për të gjithë. Së pari, duhet të punoni me këtë model e të jeni të qëndrueshëm në zbatimin e tij.

Ndryshim tjetër përmes përdorimit të këtij modeli është edhe se do të ndiheni më mirë kur të përqendroheni në anët e mira të fëmijës. E me siguri që fëmija do të përgjigjet pozitivisht, e do t'ju japë më shumë arsye për t'u ndjerë pozitivë.

### **MOS HARRONI!**

Mbështetja e sjelljes pozitive në thelb nuk ka të bëjë me ndryshimin e fëmijës, por së pari me krijimin e një mjedisi të ri që mbështet sjelljen pozitive që doni të ketë fëmija. Kjo nënkupton bërjen e një plani që përcakton se kush do të ndihmojë e se çfarë do të bëni ndryshe.



## PSE DUHET TË PËRFSHIHENI DHE TË BASHKËPUNONI ME SHKOLLËN NË NDIHMË TË FËMIJËS SUAJ

Ne besojmë se edukimi është partneritet. Për këtë arsye ne ju inkurajojmë ju si prindër të bëheni pjesë aktive në promovimin dhe zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive jo vetëm në shkollë, por edhe në familje e në komunitet. Ne ju inkurajojmë të flisni me mësuesin e fëmijës suaj për rrugët e format, përmes të cilave mund të ndihmoni për të mbështetur mësimin e fëmijës dhe ju inkurajojmë të bëni pyetje e të ndani shqetësimet dhe idetë tuaja. Vetëm së bashku mund të sigurohemi se fëmija juaj po arrin potencialin e tij të plotë.

### PËRFITIMET NGA PËRFSHIRJA E PRINDËRVE

*Kur prindërit përfshihen dhe bashkëpunojnë me shkollën:*

- Nxënësit kanë arritje më të larta, pavarësisht nga statusi social-ekonomik, etnia, prejardhja dhe niveli arsimor i prindërve.
- Nxënësit i kanë notat më të mira, angazhohen më shumë dhe i bëjnë rregullisht detyrat.
- Nxënërit kanë nota më të larta dhe ka më shumë regjistrime në shkollë të mesme.
- Arritjet e nxënësve nga grupet vulnerabël pësojnë rritje të ndjeshme.

### SJELLJA E NXËNËSIT

- Nxënësit shfaqin qëndrime dhe sjellje më pozitive.
- Nxënësit kanë më shumë vetëbesim dhe ndiejnë se shkolla është më e rëndësishme.
- Sjelljet e nxënësit si përdorimi i alkoolit, dhuna dhe sjelljet antisociale pësojnë ulje.



### SI PRIND I PËRFSHIRË NË EDUKIMIN DHE ARSIMIMIN E FËMIJËS SUAJ JU MUND TË:

#### Në shtëpi

- Çojeni fëmijën tuaj në shkollë çdo ditë, por sigurohuni që të jetë i mirushqyer, të ketë pushuar mirë dhe të jetë i qetësuar.
- Tregoni interes të madh për shkollimin e fëmijës e bëjani të ditur edhe atij se sa shumë kujdeseni për mësimet e tij. Mësoni se çfarë ka ndodhur në shkollë çdo ditë dhe si është ndjerë ai në shkollë.
- Mësoni sa më shumë mbi prindërimin efikas.
- Përpiquni të mos i lini përvojat negative t'ju pengojnë në mbështetjen dhe inkurajimin e fëmijës suaj.
- Përpiquni t'i siguronit materiale të ndryshme interesante për lexim në shtëpi, dhe shpenzoni kohë duke lexuar e shkruar me të.
- Merreni në bibliotekë dhe inkurajoni leximin për kënaqësi dhe jo si detyrim.
- Rregullojini një vend në shtëpi ku ai të mbajë gjërat e shkollës e nëse është e mundur, ku të mund të bëjë detyrat dhe mësimet e shkollës, pa ndërprerë askush. Gjeni mënyra për ta përfshirë familjen në detyrat e shtëpisë së tij ose aktivitete të ngjashme e qëndroni mbështetës për nevojën e fëmijës për të bërë detyrat e shtëpisë.
- Tregoni vlerësim për punën e tij dhe vendosni në vende të dukshme punët e tij.
- Vendosni orar për të bërë detyrat e shkollës.
- Ndiqni deri në fund punën e tij dhe monitoroni detyrat e shtëpisë dhe jeni të qëndrueshëm në pritshmëritë tuaja.
- Përfshijeni në punët e shtëpisë dhe lidhni mësimet e tij të shkollës me zbatimin e tyre në jetën e përditshme.

### Në shkollë

- Vendosni një marrëdhënie të mirë me mësuesin e fëmijës suaj që në fillim të vitit shkollor përmes:
  - takimit të rregullt me stafin e shkollës.
  - telefonatave, mesazheve dhe shënimeve të shkruara.
  - takimeve me prindër e duke e përdorur këtë mundësi për të shkëmbyer informacion me mësuesin.
- Sigurohuni që komunikimi të jetë i mirë nga të dyja krahët, si nga shkolla edhe nga ju:
  - ushtroni të drejtën dhe përgjegjësinë tuaj për të pyetur dhe treguar shqetësimet që keni, në mënyrë konstruktive.
  - Kuptoni dhe gjeni mundësinë t'ia shprehni sa punë të vështirë kanë mësuesit.
  - Gjeni çdo mundësi t'i tregoni personelit të shkollës se sa punë të mirë po bëjnë.
- Pyesni për format, përmes të cilave mund të punoni me fëmijët tuaj në shtëpi për të përforcuar atë që ka bërë mësuesi në klasë.
- Dilni vullnetar për të ndihmuar në projekte të shkollë, evente, udhëtime e ekskursione etj.
- Dilni vullnetar për të ndihmuar në klasë, nëse është e mundur.
- Bëhuni aktivë në shkollën e fëmijës suaj.
- Merrni pjesë në planifikimet dhe vendimmarrjen e shkollës duke u bërë pjesë e bordeve dhe e komisioneve të saj.

### Në komunitet

- Krijoni një rrjet me prindërit e tjerë në mbështetje të shkollës e sigurimit të edukimit cilësor për fëmijën tuaj.
- Inkurajoni pjesëtarët e tjerë të komunitetit për të mbështetur edukimin efektiv në komunitetin tuaj përmes klubeve sociale, punësimit, agjensive apo pushtetit vendor e qendror.
- Mbani pritshmëri të larta si për fëmijën edhe për shkollën.



### CILI ËSHTË ROLI JUAJ NË ZBATIMIN E NDËRHYRJEVE PËR SJELLJE POZITIVE

Në këtë pjesë të udhëzuesit po paraqesim disa ide sesi mund të përfshihen në shkollën e fëmijës suaj në zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive dhe -sesi mund ta zgjeroni këtë qasje edhe në shtëpi.

Qasjet si Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive -të bëjnë pjesë në mësimin e sjelljeve të pritshme, ndaj kërkojnë përpjekje të rregullta e të vazhdueshme në të gjitha mjediset kryesore ku rritet fëmija, si në shkollë, ashtu edhe në shtëpi. Kur një nxënës shfaq sjellje sfiduese në shkollë, ka shumë mundësi që t'i shfaqë këto sjellje edhe në familje. Për këtë arsye duhet vendosur një partneritet i fortë shkollë-familje, në mënyrë që të rriten mundësitë që strategjitë e ndërhyrjes të jenë të suksesshme.

Në ndërhyrjet për Sjelljet Pozitive, përfshirja e familjes shihet si faktor kyç. Aktualisht fokusi i ndërhyrjeve në zbatimin e NSP-ve ka kaluar nga qasja ku ndërhyrja ka në qendër individin, në theksimin e ndërhyrjes në ekip në nivel shkolle me fokus të veçantë në përfshirjen e familjes, në të gjitha nivelet e parandalimit të sjelljes. Nuk janë të paktë prindërit që shprehin dëshirën të përfshihen aktivisht në programin për mbështetjen e sjelljes së fëmijës së tyre.

Më poshtë ju sugjerojmë disa ide për përfshirjen tuaj në nivele të ndryshme të mbështetjes së sjelljes së fëmijëve.

**Çfarë mund të bëjnë prindërit në nivele të ndryshme të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive?****Në ndërhyrjet në mbarë shkollën:**

- a. Lexoni materialet e ofruara nga shkolla lidhur me Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive.
- b. Merrni pjesë në trajnimet e ofruara nga shkolla për të mësuar modelin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive.
- c. Merrni pjesë në planifikimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive.
- d. Ndani informacion me shkollën për prioritetet dhe çështjet më të rëndësishme të familjes suaj si dhe informacion tjetër të nevojshëm për vlerat, besimet dhe praktikën në komunitetin tuaj
- e. merrni pjesë në diskutimet që bëhen për të vendosur harmoni mes pritshmërive të familjes për sjelljen e fëmijës dhe pritshmërive të shkollës.
- f. Çojini në shtëpi e në lagje iniciativat dhe modelin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive
- g. Mësoni si të ndihmoni fëmijët tuaj për rëndësinë e pritshmërive të sjelljeve të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në shtëpi dhe në lagje
- h. Përpiquni të ndërtoni një model të ngjashëm me shkollën edhe për ediset e tjera të fëmijës (në shtëpi dhe lagje).
- i. Diskutoni dhe mësojini sjelljet e pritshme të fëmijës suaj.
- j. Zbatoni strategjitë e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në shtëpi dhe komunitet.
- k. Përforconi strategjitë e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në shtëpi dhe komunitet.
- l. Ndihmoni në sigurimin e pjesëmarrjes së prindërve të tjerë.
- m. Ndihmoni familjet e tjera të kuptojnë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive.
- n. Ideoni dhe realizoni iniciativat të ndryshme të prindërve.
- o. Përpiquni të krijoni lidhje të tjera për të mbështetur familjet e tjera në mënyrë më të organizuar.
- p. Krijoni lidhje të mëtejshme me komunitetin për të gjetur mbështetje për përpjekjet e shkollës.
- q. Kërkoni donacione në komunitet për të mbështetur zbatimin e programeve të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive.



#### Në ndërhyrjet në grupe të vogla:

- a. Jepini informacionin e nevojshëm mësuesit të klasës për vlerat kulturore të familjes suaj, besimet dhe praktikatat në rritjen dhe disiplinimin e fëmijës.
- b. Merrni pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve të planifikuara në klasë.
- c. Mbështesni përpjekjet e planifikuara nga mësuesi kujdestar me nxënësit në klasë.

#### Në ndërhyrjet individuale

- a. Merrni pjesë në mbledhjen e ekipit që harton planin individual të mbështetjes së sjelljes së fëmijës
- b. Jepni informacion për pikat e forta dhe nevojat e fëmijës për të hartuar një plan më cilësor për sjelljen
- c. Jepini sugjerime ekipit që harton planin e sjelljes bazuar në dijen dhe qasjen tuaj për fëmijën
- d. Informoni ekipin për strategjitë apo ndërhyrjet, që janë më të pranueshme për anëtarët e tjerë të familjes
- e. Advokoni për nevojat e fëmijës suaj me pjesëtarët e tjerë të ekipit.
- f. Rishikoni të dhënat e arritjeve për të përcaktuar efektivitetin e strategjive të zbatuara nga plani i sjelljes.



# KAPITULLI I KATËRT

## NDËRHYRJET PËR SJELLJE POZITIVE DHE FORMAT E PRINDËRIMIT POZITIV



Ndërhyrjet për sjelljet pozitive bëjnë pjesë në mënyrat e disiplinimit dhe të prindërimit pozitiv të fëmijëve dhe të rinjve, pa përdorur dhunë a ndëshkim. Nisur nga pyetjet e prindërve dhe përvoja jonë e gjatë me ta, në këtë kapitull dëshirojmë të qartësojmë me ju disa çështje të rëndësishme që lidhen me të kuptuarit e disiplinës dhe përdorimit të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në një kontekst më të gjerë të edukimit dhe rritjes së fëmijës.

Në disa raste, prindërit nuk arrijnë të kuptojnë thelbin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive dhe të vetëdisiplinimit të fëmijës e pa dashje i kthejnë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive në një formë të re për të manipuluar apo ndëshkuar fëmijën. Nga ana tjetër, disa prindër e kanë të

vështirë zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në grupmosha të ndryshme, për këtë arsye, ky kapitull synon të qartësojë se çfarë është disiplina, simund të kuptohet roli ynë si prindër në disiplinimin e fëmijës pa dhunë, dhe se çfarë duhet të kemi parasysh në zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive me grupmosha më të rritura, bashkë me një numër strategjish e sugjerimesh të vlefshme për disiplinën dhe zbatimin e saj në këto grupmosha.

### ÇFARË ËSHTË DISIPLINA?

Disiplina është dhurata e dytë më e rëndësishme që mund t'i bëjmë fëmijës. Sepse sigurisht që e para është dashuria. Por siguria që fëmija gjen te disiplina, është thelbësore, sepse pa disiplinë nuk ka kufij. Fëmijët kanë nevojë për kufij, pasi gjejnë siguri në to.

*Disiplinë do të thotë ta mësosh, jo ta ndëshkosh fëmijën. Sigurisht që kjo nuk ndodh brenda një nate. Ajo kërkon punë të vazhdueshme dhe shumë durim. Qëllimi afatgjatë i disiplinës është brendësimi te fëmija i vetëkontrollit, derisa të jetë i aftë t'i vendosë vetes kufijtë. Por ky proces do të kërkojë vite të tëra. Mundësitë për t'i mësuar fëmijës disiplinën fillojnë shumë më herët seç mund të mendojnë shumë prej nesh, dhe pikërisht që në ditët e para të jetës së foshnjës.*

Disiplina është udhëzim dhe mësim i fëmijës për të ndjekur një kod të caktuar sjelljeje, etike apo rregulli. Qëllimi i dyfishtë i saj është nxitja e sjelljeve të dëshiruara dhe korrigjimi i atyre veprimeve, që janë shqetësuese dhe jo bashkëpunuese. Disiplina është udhëzim për mënyrën, se si fëmija të përmbajë dhe të menaxhojë veten.

SYNIMI final i disiplinës është nxitja e vetëdisiplinës, vetëkontrollit, rregullimit emocional, rregullimit të impulseve agresive dhe ndërtimi i kapacitetit për të nxitur motivimin për t'i ruajtur këto aftësi të fituara. Këto arritje formojnë rrugën drejt vetëkontrollit. Disiplina e shëndetshme përfshin udhëzime të qarta, preferenca optimale dhe pasoja logjike e realiste për sjelljet e papranueshme. Kjo ndërhyrje arrihet më mirë përmes gjuhës së qartë në përputhje me moshën dhe të kuptuarin e fëmijës. Qetësia, fjalitë e shkurtra dhe specifikimi i sjelljes karakterizojnë diskutimet efektive.





## MOS NGATËRRONI NDËSHKIMIN ME DISIPLINËN!

Prej shumë brezash, ndëshkimi , në vendin tonë, është ngatërruar me disiplinën, një praktikë kjo e aplikuar ende gjerësisht. Ndëshkime të tilla i referohen përdorimit të forcës fizike dhe psikologjike, në mënyrë që fëmija të përjetojë një shkallë të caktuar dhimbjeje dhe shqetësimi me synim ndryshimin e sjelljes së fëmijës. Në fakt disiplina nuk është as ndëshkim, as dhunë e nuk duhet ngatërruar kurrë me to.

Kur i ndëshkojmë fëmijët për gabimet e tyre, ne fokusohemi në atë që kanë bërë e duam “të vendosim drejtësi” për atë që ndodhi. Ndërkohë kur i dispiplinojmë fëmijët, ne shohim përpara në të ardhmen e i pajisim ata me aftësitë e nevojshme që të ndryshojnë mënyrën si mendojnë e më pas edhe veprimet e tyre.

## *Bindje të gabuara që nxisin ende ndëshkimin dhe dhunën ndaj fëmijëve*

Shpesh besime e qëndrime të caktuara në një kulturë të caktuar, mbajnë gjallë sjellje të caktuara tek ajo kulturë. Në vendin tonë por edhe në të gjithë rajonin vihen re se besimet e mëposhtme janë disa nga më të shpeshtat të vërejtura nga bisedat me prindërit.

- Bindja nr. 1**            “Më ka bërë mua vaki dhe s’më ka gjetur gjë.”
- Bindja nr. 2**            “S’ka mbetur rrugë tjetër.” “vetë e kërkojnë.”
- Bindja nr. 3**            “Ndëshkimi fizik funksionon më mirë e më shpejt. Metodat e tjera jo.”
- Bindja nr. 4**            “Ndëshkimi fizik i mëson si të binden.”
- Bindja nr. 5**            “Unë e përdor vetëm si mjet të fundit, kur s’kam zgjidhje tjetër.”
- Bindja nr. 6**            “Është e vetmja mënyrë për t’i mbajtur nën kontroll të gjithë fëmijët. Unë kam shumë fëmijë.”
- Bindja nr. 7**            “Ndëshkimi fizik është pjesë e kulturës sonë.”



### *Çdo formë disiplinimi duhet të marrë në konsideratë ndjenjat*

Pse sillen fëmijët - dhe të rriturit - ashtu si sillen?

Përgjigja përherë janë ndjenjat. Janë ndjenjat ato që drejtojnë sjelljen. Ndjenjat janë motivueset e veprimeve tona. Njerëzit lindin me nëntë ndjenja: interesin, habinë, gëzimin, shqetësimin, zemërimin, frikën, turpin, neverinë dhe mospëlqimin e aromave. Këto ndjenja kombinohen me njëra-tjetrën dhe me anë të përvojës, ndërsa rritemi, formohen emocione edhe më komplekse.

**Problemi me ndëshkimin dhe dhunën është i dykrahshëm. Nga njëra anë, ndëshkimi nxit pikërisht ato ndjenja negative që nuk duam të shtohen tek fëmijët si: zemërimi, frika, turpi dhe neveria. Së dyti, ndëshkimi shtyp pikërisht ato ndjenja që dikush dëshiron t'i inkurajojë te fëmijët, si interesi dhe gëzimi.**

### *Drejtoni përmes shembullit tuaj*

**Veproni si ai person që doni që ata të bëhen.** Përpiquni të jetoni sipas cilësive dhe vlerave të përgjithshme, që ju vetë admironi (p.sh.: pranimi, ndershmëria, bujaria etj.). Motivoni veten të jeni të këndshëm, mbështetës dhe të dashur.

**Mos harroni:** marrëdhëniet dhe proceset emocionale mbështesin rritjen dhe zhvillimin e mendjes. Është marrëdhënia cilësore me ju, që mundëson përmirësimin e inteligjencës emocionale, frytet e së cilës piqen gradualisht duke sjellë vetëdërgjegjësim, vetëmenaxhim dhe aftësi më të mira për marrëdhënie dhe vendimmarrje më të përgjegjshme. Fokusimi te sjelljet pozitive rrit suksesin. Është shumë e rëndësishme që kjo të nisë që ditën e parë të jetës së fëmijës.

## Praktika pozitive për të disiplinuar fëmijët e moshës 10 - 18 vjeç (fëmijët në moshën e pubertetit dhe adoleshencës)

Në moshën 10 deri në 13 vjeç mbaron epoka e komandave dhe vjen epoka e miratimit (ku fëmija e di se prindërit nuk mund t'i ndalojnë apo t'i bëjnë gjërat pa miratimin e tij).

Zbatimi i disiplinës nga ana e prindit shpesh nuk gjeneron përgjigje pozitive te fëmijët në këtë grupmoshë. Për ta ruajtur disiplinën efektive gjatë kësaj periudhe, kujdesuni shumë për lidhjen me ta përmes komunikimit dhe shoqërimit ,sepse fëmijët dhe të rinjtë që kanë lidhje të mirë me ju, janë më të predispozuar për të miratuar kërkesat ndaj tyre.

*Lidhja është thelbësore në disiplinim.* Në një marrëdhënie jociësore ndërmjet prindit dhe fëmijës/adoleshentit, ai e ka më të vështirë për ta dhënë miratimin. Kështu që prindërit duhet të gjejnë mënyra që të kombinojnë lidhjet pozitive, sidomos bëjnë korrigjime negative. Në të kundërt do të jetë edhe më e vështirë, sepse fëmija/adoleshenti ndjen se “nëse ti vetëm më kritikon dhe ndëshkon, edhe unë do të zemërohem dhe refuzoj çdo kërkesë!”

Qëllimi kryesor i disiplinës prindërore është mësimi i vetëdisiplinës. Ndryshe disiplina mund të përkufizohet si bashkimi i shumë udhëzimeve dhe pak korrigjimeve që e mësojnë adoleshentin të jetojë sipas rregullave dhe normave të familjes. Gjatë kësaj periudhe, disiplina e prindit nuk është kontrolli i jetës së tij, por mësimi i tij për të përvetësuar vetëdisiplinën të mjaftueshme, për të qenë në gjendje të jetë i pavarur dhe i përgjegjshëm për të menaxhuar veten.

Kur fëmija/adoleshenti thotë: “po më shkatërroni jetën, se më kontrolloni për çdo gjë”, prindërit mund të përgjigjen “JO, jemi pranë teje për të të përgatitur për ta drejtuar vetë jetën tënde.”



Në përvojën tonë kemi parë se disa praktika disiplinuese, kur zbatohen me kujdes sjellin ndryshim në mënyrën si rriten fëmijët më të rritur dhe adoleshentët. Më poshtë kemi paraqitur dhjetë prej këtyre praktikave:

7. **RREGULLA TË QARTA DHE TË QËNDRUESHME.** Prindërit përshkruajnë specifikisht çfarë lejohet dhe çfarë jo, çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të ndodhë, e nuk e thyejnë besimin me këto rregulla bazë themelore. P.sh. “Nuk mund t’i përdorësh gjerat e dikujt tjetër pa i marrë fillimisht leje.”
8. **INSISTIM I QETË.** Kur kërkon qe të bëhet diçka, qëndroni pas fëmijës qetësisht por duke e përsëritur derisa kërkesa të përmbushet. Mos u mërzisni apo të inatoseni për të arritur qëllimin. Por as mos harroni se çfarë kërkuat e as mos u dorëzoni. Fëmija më i rritur /adoleshenti e di se nëse për prindin është e rëndësishme për ta kërkuar, është po aq e rëndësishme që të bëhet në kohë. Për shembull prindi insiston “Të kërkoja ndihmë para një ore për të rregulluar shtëpinë dhe po e përsëris këtë kërkesë”.
9. **KORRIGJIMI NUK JEPET PËRMES VLERËSIMIT.** Kur korrigjoni sjelljen, mos e bëni në mënyrë kritike dhe fajësuese, por përqendrohuni vetëm te veprimet dhe sjelljet e fëmijës dhe se çfarë duhet të bëjë ndryshe. Për shembull, “Ne nuk jemi dakord me vendimet e tua, për këto arsye, e si rezultat këto do të ndodhin e këto do të jenë gjërat që ne shpresojmë të mësoh nga ajo që bëre”.
10. **SJELLJA POZITIVE MERR APROVIM DHE VLERËSIM POZITIV.** Kur shihni sjelljen e fëmijës/adoleshentit, jo vetëm supervizoni atë që duhet të korrigjohet dhe të përmirësohet, por vlerësoni dhe miratoni gjithashtu edhe atë sjellje që meriton vlerësim. Fëmija/adoleshenti duhet të dijë se prindërit e vendosin çdo gabim a sjellje jo të përshtatshme brenda një konteksti më të gjerë të çdo gjëje që ai bën mirë (dhe e çdo gjëje që mund ta bënte keq por nuk po e bën keq). Për shembull: “çdo problem a telash që shkakton janë pjesë të vogla të një individi të madh e me vlera, i cili ne besojmë që në përgjithësi e menaxhon mirë veten”.



11. **PRISNI TË SHPREHË MENDIMIN E VET.** Kur e përballni adoleshentin në lidhje me një gabim a sjellje të papërshtatshme, përgatituni edhe të dëgjoni shpjegimin e tij se çfarë ndodhi dhe pse. Gjeneri mundësi të shprehni pozitivitet për versionin që ai jep për ngjarjen edhe kur nuk e besoni këtë version. Adolehenti ka nevojë të dijë se çdo herë që kërkohet ndërhyrja e prindit për të disiplinuar sjelljen e tij, së pari ai do të ketë mundësinë të ketë një dëgjues të plotë e të ndershme kështu që të paktën të tregojë si shih ai në anën e tij gjërat. Kjo, përveç të tjerash, e ndihmon të ndërtojë aftësi të rëndësishme për veten. Për shembull, dëgjoni ndërsa ai shpjegon: “Ishte shoqëria dhe rrethanat që më shtynë të veproja, ashtu si veprova”.
12. **MARRËDHËNIE RECIPROKE.** Marrëdhënia me fëmijët e kësaj grupmoshe është reciproke. Nëse kontribuoni në jetën e tij, bëjani të ditur se prisni nga ai të njëjtën gjë. Në këtë aspekt, marrëdhënia prind - adolehenti është marrëdhënie kontraktuale, ku prindi e bën të qartë se si duhet të funksionojë nga të dyja palët e jo vetëm nga njëra palë. Fëmija/adolehenti e di se ai jeton në një sistem familjar ku nëse merr, edhe do të japësh. Për shembull: “ne bëjmë për ty dhe ti për ne.”
13. **SHQETËSIMI T’I PARAPRIJË PASOJËS.** Kur të përballeni me sjelljen negative të fëmijës/adolehentit përgjigja e parë duhet të jetë jo korigjuese, por empatike. Së pari pyesni nëse është mirë, nëse ndihet mirë, nëse ka diçka për çështjen që ai ka nevojë të flasë me ju. Sjellja e gabuar mund të tregojë se ka diçka që po ndodh në jetën e tij që po çon në këto gabime. I riu duhet të dijë se, madje edhe si përgjigje ndaj sjelljes së gabuar, shqetësimi prindëror për mirëqenien e tij vjen përpara se ai të vendosë se çfarë është e përshtatshme për atë që bëri. Për shembull, pas incidentit, pyetja e parë e prindit mund të jetë: “Na trego për veten përpara se të flasim se çfarë duhet të kishte ndodhur.”



14. **ZGJEDHJET PERSONALE RESPEKTOHEN.** Me ardhjen e pubertetit dhe adoleshencës fëmijët po hyjnë nga periudha e komandave në periudhën e miratimit. Zakonisht adoleshentët me sjellje deviante shprehen “as nuk më ndalon dot e as nuk vendos ti për mua!” “Dakord” thonë prindërit. “Ti je përgjegjës për zgjedhjet e tua (dhe përballjen me pasojat e zgjedhjeve që bën), dhe ne nuk e diskutojmë këtë liri.” Për shembull, prindërit shpjegojnë: “Mënyra si zgjedh të sillësh është çështje e jotja, por duhet të dish se zgjedhja jote ndikon sesi do të zgjedhim ne të sillemi me ty pas kësaj.”
15. **JEPNI UDHËZIMETË NDERSHME.** Prindërimi është angazhim për t’i dhënë fëmijës udhëzime të vazhdueshme, gjë që e ndihmon fëmijën të kuptojë botën, marrëdhëniet, sjelljen e të rrënjës së vlerat. Kur komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe i ndjeshëm, fëmija e di se çdo këshillë e dhënë jepet me mirëqenien e tij në mendje e kështu që merret më mirë. Për shembull, pasi ai të ketë pasur një episod të vështirë me shokët, ju mund t’i thoni: “Ne mendojmë ndryshe për atë që ndodhi e dhe do të donim ta përfshije në mënyrën si i shikon gjërat edhe këtë perspektivën tonë.”
16. **PASOJA E PARË ËSHTË KOMUNIKIMI.** Fëmija duhet të dijë se gjërat në familjen tuaj nuk kalojnë pa u biseduar. “Sa herë që ndodh diçka serioze” ju duhet t’i shpjegoni “përpara se të vendosim për ndonjë pasojë të logjikshme për atë që ndodhi, duhet së pari të flasim për atë që ndodhi. Duhet të dëgjojmë atë që ndodhi e ti duhet të na dëgjosh gjithçka kemi për të thënë.” E më pas duhet të prisni e të shihni se çfarë, nëse po, pasoja të tjera do të shfaqen/ për shembull, nga përvoja e përsëritur, fëmija/adoleshenti ka mësuar se “që sa herë i bëj lëmsh gjërat, e di se gjëja e parë që do të ndodhë do të jetë ajo që prindërit e mi e quajnë “një bisedë e fortë”.



## *Mjete bazë në qasjet pozitive të disiplinës me fëmijët më të rritur dhe adoleshentët*

### **1. Udhëzimi**

Udhëzimi është përgjigje ndaj pyetjeve të tilla si: Çfarë nuk di fëmija/adoleshenti, çfarë ka nevojë të dijë dhe të dijë se nuk është kështu? Udhëzimi nuk është imponim për të ndryshuar mënyrën e të menduarit apo bindjet e adoleshentit. Ai ofron një perspektivë të shtuar për të që të të marrë në konsideratë, kur të marrë një vendim. Mos kini frikë të jepni informacion dhe ngrini çështje pavarësisht sa jomikpritëse mund të duket kjo. Edhe kur duket se nuk e merr në konsideratë këndvështrimin tuaj, ai ju dëgjon. Ata prindër që e kanë perfeksionuar këtë strategji, shpesh nuk kanë nevojë për të tjera. Pse? Sepse ai e di se çdo gabim apo sjellje negative, do të diskutohet mirë me prindërit. Do të diskutohet çfarë ndodhi, pse ndodhi dhe ku ndodhi, çfarë duhet të ndodhë më pas e si nuk duhet të përsëritet.

### **2. Struktura**

Struktura e familjes është krijuar nga prindërit me rregullat sociale dhe procedurat se si do të funksionojë kjo familje dhe se si duhet të sillen pjesëtarët e kësaj familjeje. Fëmijët socializohen bazuar në strukturën e familjes. Ata mësojnë të bëjnë çfarë presin prindërit, dhe brendësuar kodin e sjelljes personale dhe mësojnë se çfarë nuk duhet të bëjnë. Bazuar në strukturën e familjes, ata mësojnë se kush duhet të bëjë çfarë dhe kush duhet të marrë cilat vendime. Struktura është shumë e rëndësishme, sepse jo vetëm i jep siguri fëmijës, por edhe e siguron adoleshentin, edhe pse ai e kundërshton strukturën, ngaqë kërkon më shumë liri. Mungesa e strukturës në familje nuk e çliron fëmijën/adoleshentin, madje e tremb. Prindërit që vetëm e lejojnë fëmijën të bëjë ç' të dojë, janë të frikshëm. Detyra e prindërve është të krijojnë dhe drejtojnë strukturën e familjes, duke çmuar kompromisin kur është e mundur dhe duke e korrigjuar fëmijën, kur sjellja e tij nuk përshtatet me strukturën, në të cilën rritet fëmija.



### 3. Mbikqyrja

Mbikqyrja ka dy forma: kontrolli i fëmijës/adoleshentit për të parë nëse e bëri atë që tha, dhe ndjekja e tij për të bërë detyrat që i takojnë. Me ardhjen e adoleshencës, fëmija bëhet më rezistent (ndonjëherë edhe në mënyrë pasive duke i vonuar gjërat) ndaj rregullave dhe kërkesave. E rëndësishme është të jemi të qëndrueshëm e konsistentë. Ndaj është e rëndësishme për prindin të mos e vendosë një rregull apo të kërkojë diçka, nëse nuk është i përgatitur për ta ndjekur çështjen derisa të plotësohet kërkesa. Mbikqyrja ka të bëjë edhe me insistimin dhe përsëritjen e vazhdueshme për plotësimin e përgjegjësive dhe detyrave, për ta lodhur rezistencën e fëmijës. Kur fëmija/adoleshenti thotë “Nuk e duroj dot kur më bezdis”, prindi bie dakord dhe thotë: “Edhe mua më duket e lodhshme. Por është një punë e nderuar dhe kur do të kesh nevojë për ndihmën time për të përfunduar diçka, unë do ta bëj.” Një formë e supervizimit është edhe ajo që quhet pritja aktive. Kurkeni kërkuar diçka nga fëmija juaj dhe ai nuk po e bën, gjëni mundësi gjatë ditës për t’i kujtuar se “unë po pres e do të vazhdoj të pres derisa të bësh atë që të kërkova.”

### 4. Shkëmbimi i pikëve

Prindërit duhet të qëndrojnë për reciprocitet dhe dhënie të dyanshme në marrëdhënie edhe përmes shkëmbimit të pikëve. Për shembull, kur, fëmija juaj, nxënës i klasës së nëntë, ju kërkon ta çoni diku me makinë të takojë një shok, përpara se të bini dakord i thoni: “A ka diçka që të kërkuam të bësh që nuk është bërë akoma, apo diçka që ne kërkojmë paraprakisht si shkëmbim për bashkëpunimin tonë? Më pas i thoni: “Ne do të të marrim me kënaqësi, por përpara se ta bëjmë, duhet të na japësh ndihmën që të kërkuam”. “Ju premtoj se dot’ju ndihmoj kur të vij në shtëpi,” thotë ai. “Jo. Premtimet janë monedha false. Vetëm veprimet vlejnë. Duke theksuar rëndësinë e shkëmbimit, prindërit shpjegojnë: “Së pari, ti bën për ne, dhe pastaj ne për ty. Në këtë mënyrë secili nga ne bën diçka me vlerë për tjetrin, dhe funksionon marrëdhënia për të dy.”





## 5. Përgjegjësia

Liria duhet të vijë me një kosto në adoleshencë, dhe emri i kësaj kostoje është përgjegjësia, që mësohet dhe fitohet duke brendësuar zgjedhjet, që dikush bën, edhe duke përballuar pasojat që ndjekin ato zgjedhje. Zgjedhjet e mira vijnë me përfitimet përkatëse, kurse zgjedhjet e këqija me pasoja të hidhura. Edhe pse është shumë joshëse të mbrosh fëmijën e të ndërhysh te zgjedhja e tij e gabuar apo pasoja që ndjek, me qëllim për të shmangur dëmtimin e fëmijës, prindërit e bëjnë këtë në kurriz të fëmijës - sepse ai humb mundësinë e rëndësishme për të përfituar nga kjo përvojë e dhimbshme. Nëse fëmija/adoleshenti do të mësojë aftësi të mjaftueshme për menaxhimin e vetes dhe jetës për të mbështetur pavarësinë e tij, marrja e përgjegjësisë për zgjedhjet/pasojat e tij është esenciale. Ai duhet të jetë në gjendje të thotë: “Për vendimet që marr dhe rezultatet e këtyre veprimeve, nuk kam se kë tjetër të fajësoj veç vetes, e do të mësoj nga kjo përvojë.”


**Mos harroni:** disiplina prindërore është përgjegjësi, por edhe art - krijimi i influencave që e mbajnë fëmijën e kësaj moshe në një rrugë të mbarë e konstruktive, ndreqja e gabimit dhe ndihma për të shkuar në drejtim të shëndetshëm, janë në thelb të strategjive disiplinuese. Udhëzimi dhe mbështetja duhet të jenë të parët. Korrigjimi duhet të luajë një rol më të vogël.

Rëndësia e disiplinës në përvetësimin e vetëdisiplinës mund të shpjegohet nga një ekuacion i thjeshtë **tani = më vonë**. Një fëmijë/adoleshent është një person në trajnim për t’u rritur. Prindërit janë ende trajnuesit e tij kryesorë. Është në lojë mësimi i aftësive të mjaftueshme për vetëmenaxhim, mbështetja për një pavarësi konstruktive, në mënyrë që adoleshencia të përfundojë me sukses.



***Mos harroni!***

Të mësosh të disiplinosh me qetësi e dashuri, por në mënyrë të prerë kur është e nevojshme, nuk ndodh brenda një nate. Porshpërblimi është rritja e një fëmije me sjellje të mirë, të ekuilibruar emocionalisht dhe të pavarur. E për prindërit që thonë se kanë provuar gjithçka, por asgjë nuk funksionon, me respekt i ftojme të ndryshojnë mentalitetin.





# SHTOJCA NR. 1

Model i Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në Shtëpi

	Zgjimi në mëngjes	Përgatitja për në shkollë	Koha për higjienë personale	Koha për t'u qetësuar	Koha e detyrave të shtëpisë	Vaktet/koha e ushqimit	Përgatitja për gjumë
I sigurt							
I respektueshëm							
I përgjegjshëm							



## SHTOJCA NR. 2

### SHEMBUJ TË RREGULLAVE NË SHTËPI

#### I respektueshëm



Unë i dëgjoj prindërit.  
Unë u tregoj të vërtetën prindërve.  
Unë jam bashkëpunues.  
Unë komunikoj me mirësjellje.

#### I përgjegjshëm.



Unë i vë vetë në vend gjërat e mia.  
Unë ndihmoj në punët e shtëpisë.  
Unë zbatoj gjërat që më porosit prindi.  
Unë ua tregoj prindërve notat dhe atë që më ndodh në shkollë.  
Unë jam i përgatitur për në shkollë:  
U tregoj prindërve fletoren e detyrave  
I mbaroj detyrat dhe i konsultoj me prindërit  
Shkoj të fle në kohë  
Ngrihem dhe bëhem gati për në shkollë

#### I sigurt



Unë luaj me kujdes me të tjerët  
Unë qëndroj në vendet e përcaktuara dhe të aprovuara nga të rriturit  
Unë u qëndroj larg të panjohurve.  
Kur i jap biçikletës, përdor kokore dhe pajisjet e nevojshme.



## SHTOJCA NR. 3

### Shembull i zotimit të prindit

(kryesisht për ata prindër, fëmijët e të cilëve kanë pasur shoqëri të papërshtatshme ose të rrezikshme)

*Unë premtoj të të ndihmoj në shkollë për AKTIVITETET dhe zgjedhjet që bën.*

*Do të bisedoj me ty çdo ditë e nuk do të të LARGOJ APO TALLEM me ty, kur më kërkon ndihmë.*

*Të premtoj se do të përfshihem në jetën tënde në çdo kohë e se do të kujdesem të shoh se ku shkon e me kë je.*

*Do të bëj më të mirën për të të SIGURUAR një shtëpi të sigurt e të lumtur, edhe në kohë të VËSHITIRA.*

*Do të bëj çdo gjë që mundem të të MBAJ LARG shoqërive të rrezikshme.*

*Do të përpiqem të jem një model i mirë për ty e të tregoj kur bën zgjedhje të MIRA.*


*Premtoj të të DUA, PAVARËSISHT GJËRAVE që bën.*

Prindi:

Data:

Prindi:

Data:





## SHTOJCA NR. 4

### LISTË KONTROLLI PËR PËRFSHIRJEN E PRINDËRVE

Shkolla: \_\_\_\_\_ : \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

<b>STATUSI:</b> Po ndodh Po ndodh pjesërisht Nuk po ndodh	<b>DETYRA</b>	<b>PËRPARËSIA:</b> I lartë I mesëm I ulët
	<b>KLIMA</b>	
	1. Ka një proces për të vlerësuar sa të mirëpritur, të vlerësuar dhe të kënaqur janë prindërit në shkollë/me shkollën.	
	2. Shkolla ka një plan për të gjetur rrugët/format si t'i bëjnë familjet të ndihen të mirëpritura dhe të vlerësuara.	
	3. Shkolla ka një plan për të trajnuar të gjithë stafin se si të bashkëpunojë dhe të respektojë familjet.	
	4. Planet për gjetjen e rrugëve për të ndihmuar familjet që ata të ndihen të mirëpritura, përfshijnë familje të ndryshme, edhe ato që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara apo probleme në sjellje.	



	PËRFSHIRJA E PRINDIT NË AKTIVITETET MËSIMORE NË SHTËPI	
	5. Ka një proces për të vlerësuar opinionet e prindërve për përfshirjen e tyre në aktivitetin mësimor me fëmijën e tyre në shtëpi.	
	6. Ka një plan ose grup aktivitesh për të ndihmuar familjet sesi ato të ndihmojnë fëmijët për të mësuar në shtëpi.	
	7. Plani përfshin aktivitete për të ndihmuar familje të ndryshme, përfshirë këtu familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe probleme e vështirësi në sjellje e në të nxënë.	
	Komunikimi me Prindërit/Familjet	
	8. Ka një proces për të vlerësuar opinionet e prindërve se sa mirë komunikon shkolla me ta.	
	9. Ka një plan për të komunikuar me familjet në forma të ndryshme mbështetëse.	
	10. Planipërfshinaktivitetepërtëkomunikuar me familjetëndryshme, përfshirëkëtuafamilje me nxënësngatëgjithanivelet e ndërhyrjessë NSP-ve (universale, tëtargetuadhe intensive) nëlidhje me çështjet e shkollës/ shtëpisëpërfshirëedhecështjetqëlidhen me disiplinën.	
	Përfshirja e Prindit/FamiljesnëShkollë (vullnetarizmidhendihma)	
	11. Ka njëprocespërtëmatuopinionet e prindërvepërmënyrënsimund tambështesinshkollënpërmespëfshirjessëtyrenëshkollë.	
	12. Ka një plan se simundtëpërfshihenprindëritnëmbështetjetëprocesit-tëmësiminëshkollëpërmesvullnetarizmitdheasistencës.	
	13. Planipërfshirjen e prindërvenëshkollëpërfshinfamiljetëndryshme, edheato me nxënësngatëtri nivelet e NSP-ve.	



	PËRFSHIRJA E PRINDIT/FAMILJES NË VENDIMMARRJE	
	14. Ka një proces për të vlerësuar opinionet e prindërve për të parë nivelin në të cilin inkurajohen të marrin pjesë në komitete dhe aktivitete-vendimmarrëse.	
	15. Ka një plan për të inkurajuar dhe mbështetur pjesëmarrjen e prindit në komitetet dhe aktivitetet vendimmarrëse.	
	16. Plani për pjesëmarrjen e prindërve në komitete/borde dhe aktivitete vendimmarrëse adreson mënyrën si familje të ndryshme, përfshirë edhe familje me nxënës nga të tri nivelet e NSP-ve, mund të marrin pjesë.	
	17. Ka një proces për të vlerësuar opinionet e prindërve për nivelin, në të cilin mund të japin ndihmë dhe informacion te personeli i shkollës për çështje me rëndësi, përfshirë çështjet që lidhen me disiplinën.	
	18. Ka një plan për të mbledhur dhe përfshirë të dhënat që vijnë nga prindërit për çështje me rëndësi, përfshirë edhe çështje serioze të disiplinës.	
	19. Plani për mbledhjen dhe përfshirjen e të dhënave, që vijnë nga prindërit për çështje me rëndësi përfshirë edhe çështjet që lidhen me disiplinën, adreson si familje të ndryshme, ashtu edhe ato me nxënës, me të cilët punohet në nivele të ndryshme të NSP-ve.	





## SHTOJCA NR. 5

### ANKETA E PERCEPTIMIT TË NXËNËSIT PËR Ndërhyrje për Sjellje Pozitive

Ky instrument mund të përdoret prej nxënësve që nga klasa e katërt.

	1	2	3	4
	Jam plotësisht dakord	Dakord	Nuk jam dakord	Nuk jam fare dakord
1. I kuptoj rregullat e shkollës				
2. Jam dakord me rregullat për sjelljen në shkollën time				
3. Nxënësit që thyejnë rregullat në shkollën time, kanë pasoja.				
4. Rregullat për sjelljen janë vendosur në një vend të dukshëm në klasë				
5. Unë ndihem i sigurtë dhe i qetë në shkollën time.				



6. Unë mund të marr ndihmë në shkollë, nëse ndihem se nuk jam i sigurtë.				
7. Më pëlqen të jem nxënës në këtë shkollë.				
8. Kjo shkollë është një vend mjaft miqësor.				
9. Nxënësit në shkollën time tregojnë respekt për njëri - tjetrin.				
10. Në përgjithësi mjedisi i shkollës sime është pozitiv.				
11. Nxënësit sillen vetë mirë, pa pasur nevojë për ndihmë, kështu që klima për të mësuar është pozitive.				
12. Nxënësit në shkollën time inkurajohen për të pasur sukses.				
13. Nxënësit shpërblehen për sjelljet pozitive.				
14. Shpërblimet për sjelljet pozitive jepen në mënyrë të drejtë për nxënësit.				
15. Më pëlqejnë shpërblimet që nxënësit marrin për sjelljet pozitive.				



## SHTOJCA NR. 6

### KOMPONENTËT KRYESORË TË NDËRHYRJEVE PËR SJELLJE POZITIVE NË SHKOLLË

Komponentët kryesorë të NSP-ve	Shpjegimi
Ekipi i Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive	Një grup individësh që përfshin administratën dhe stafine shkollës, që merren me nxitjen e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në të gjithë shkollën. Ekipi mbledhet rregullisht për t'u fokusuar në zbatimin, marrjen e feedbackut dhe shqyrtimin e të dhënave. Në përbërje të këtij ekipi mund të jenë nxënës dhe prindër vullnetarë.
Procedura për feedback nga stafi, prindërit dhe nxënësit.	Nëse stafi, prindërit dhe nxënësit nuk besojnë se iniciativa mund të funksionojë atëherë zbatim i Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive do të hasë vështirësi. Gjetja e formave për të marrë feedback të rregullt dhe për të dhënë informacion për mënyrën si po zbatohen Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive, si po ndryshojnë përvojat e tyre në shkollë etj.
Pritshmëritë në nivel shkollë	Përgatitja e pritshmërive për sjelljen në nivel shkollë nuk është punë e thjeshtë. Objektivat për këto pritshmëri duhet të jenë specifike e të vëzhgueshëm, por edhe të gjerë në mënyrë që të gjithë nxënësit të jenë në gjendje t'i zbatojnë, pavarësisht klasës dhe moshës. Pjesëmarrja e prindërve dhe nxënësve në këtë proces ndihmon në vendosjen e pritshmërive realiste dhe të zbatueshme.



Udhëzimi për sjelljen	Në ndihmë të zbatimit të rregullave dhe pritshmërive në nivel shkolle, stafi duhet të mësojë sjelljet e pritshme në mënyrë të planifikuar. Sigurisht që sjelljet që reflektojnë objektivat e shkollës, mund të duken ndryshe në situata të ndryshme.
Sistemi i vlerësimit të sjelljes pozitive	Vlerësimi i nxënësve për sjelljet pozitive duhet të bëhet shumë natyrshëm. Vendosni një sistem pikësh që është i qëndrueshëm për sjellje specifike. Vënia e shpërblimeve duhet të marrë sa më pak kohë, në mënyrë që mësuesi të ketë kohë që të japë mësim.
Zbatimi konsistent	Iniciativa për fillimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive është angazhim. I gjithë komuniteti i shkollës duhet të zbatojë parimet dhe objektivat e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive gjatë gjithë vitit shkollor. Kjo gjë mund të kërkojë që të ndihmohen ata pjesëtarë të shkollës që kanë vështirësi për ta zbatuar. Besnikëria në zbatim është mjaft e rëndësishme.
Zhvillimi profesional	Mësimi i stafit të shkollës për tri nivelet e ndërhyrjes duhet të përfshijë udhëzimet për pritshmëritë në nivel shkolle, vlerësimin e sjelljeve pozitive, mënyrën e korrigjimit të sjelljeve negative dhe kërkimin e ndihmës.
Sistemet dhe rutinat në nivel klase	Çdo mësues mund t'ju thotë se rutinat janë baza e menaxhimit të suksesshëm të klasës. Vendosni rutina dhe procedura, që lidhen me iniciativën e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në mënyrë që nxënësit të dinë çfarë të presin.
Procedurat e disiplinës	Një ndër objektivat afatgjatë të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive është reduktimi i ndjeshëm i referimeve të nxënësve te drejtori. Sigurisht që Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive do t'ju çojnë deri në këtë pike, por deri atëherë duhet të merreni me sjelljet negative duke përdorur mënyra pozitive disiplinimi. Krijoni një proces specifik, që i con nxënësit me probleme në sjellje drejt një objektivi të saktë.



Mbledhja e të dhënave	Përpiquni të kuptoni sesi po realizohet iniciativa juaj për zbatimin e Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive në mungesë të të dhënave të besueshme. Do t'ju duhen këto të dhëna për të marrë vendime më objektive.
Vlerësimi dhe raportimi	Monitoroni përparimin e shkollës gjatë vitit shkollor.
Përfshirja e nxënësve, familjes dhe komunitetit	Bëni rregullisht anketime të stafit, nxënësve dhe familjeve. Kërkoni feedback të paktën një herë në vit. Të dhënat do t'ju ndihmojnë të kuptoni ku duhet të bëni ndryshime e çfarë po funksionon mirë.



## SHTOJCA NR. 7

### REFLEKTIM MBI ZEMËRIMIN E PRINDËRVE

Prej vitesh takoj prindër që kërkojnë ndihmë, që të mësojnë se si të menaxhojnë më mirë veten dhe fëmijën e tyre. Në shumicën e rasteve kam vënë re se këta prindër kanë qenë vetë viktimë të dhunës dhe ndëshkimit fizik, kur kanë qenë fëmijë. Në të shumtën e rasteve ata thonë: “Po kam qenë fëmijë i keq e trazovaç i madh” “Po kështu ishin të gjithë prindërit në atë kohë”, “Ndodhte shumë rrallë që të më rrihte”, “Nuk dinin çfarë të bënin tjetër”, “Po çfarë na gjeti tek e fundit nga kjo”?

Nga përvoja me këta prindër kam kuptuar se në shumicën e rasteve kanë harruar si janë ndjerë në atë kohë, ndaj dhe përpiqen të mohojnë apo qoftë edhe të zvogëlojnë mënyrën negative sesi ka ndikuar ndëshkimi në marrëdhëniet që kanë pasur me prindërit, sa i është thyer besimi te prindi nga kjo përvojë dhe sa zemërim, turp, dhimbje dhe paqartësi kanë përjetuar. Përvoja të tilla i kanë bërë të humbin lidhjen me emocionet dhe veten e tyre. Kjo shpesh ka cuar në humbjen e aftësisë për të qenë më empatikë ndaj dhimbjes që kanë përjetuar, gjë që me kalimin e kohës ka kontribuar në uljen e aftësisë për të qenë empatikë ndaj dhimbjes së të tjerëve. Shpesh kjo është edhe arsyeja pse ata nuk e përmbajnë veten ndaj ndëshkimit fizik të fëmijëve të tyre. Edhe pse e shohin ndëshkimin fizik si një mënyrë disiplinimi të fëmijëve, nga mënyra si rrjedhin gjërat, shihet se ndëshkimi fizik që ata përdorin vjen më shumë si rezultat i inatit që i kap kur ndihen të shqetësuar apo të pafuqishëm, kur fëmijët e tyre nuk bëjnë atë që duhet bërë. Kështu që është e qartë pse e përdorin ndëshkimin fizik si mënyrë më të shpejtë për disiplinim të fëmijëve. Tek e fundit, është kaq e thjeshtë ta përdorësh. Ndëshkimi fizik nuk kërkon as vetë përmbajtje e durim dhe as reflektim e ndjeshmëri.



Prindërit shpesh më tregojnë se kanë vënë re që, edhe pse për momentin ndëshkimi fizik, kërcënimi dhe frikësimi mund të funksionojnë, e shpesh e shpërblen prindin, sepse arrin kontroll të shpejtë mbi fëmijën, gjatë viteve kjo sjell pasoja të mëdha tek fëmija dhe lidhja mes tyre.

Besimi dhe siguria që fëmija ka te prindi i tij janë ato që ndërtojnë, nga pikëpamja e zhvillimit afektiv, emocionet pozitive dhe rrisin shëndetshëm fëmijën. Ndëshkimi fizik është thyerje dhe shkatërrim i besimit dhe i sigurisë së tij si dhe i rolit që çdo prind ka për të mbrojtur fëmijën nga çdo dëmtim. Thyerja e besimit dhe të sigurisë ka pasoja të rëndësishme në marrëdhënie dhe zhvillim, në vetë-vlerësimin e fëmijës, inteligjencën emocionale, që është aftësia për të njohur ndjenjat e veta dhe për t'i vetë-rregulluar këto ndjenja, si dhe në rëndësinë që kanë të tjerët për të.



## SHTOJCA NR. 8

### KËSHILLA PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE TË RRRITUR E ADOLESHENTË

1. Flisni çdo ditë me fëmijën tuaj dhe dëgjojeni me vëmendje.
2. Vëzhgoni me kujdes, nëse ka shenja a simbole që tregojnë se mund të jetë dëmtuar, apo shenja që tregojnë se mund të jetë përfshirë në shoqëri/grupe të papërshtatshme.
3. Pyeteni për dëmtime në trup që nuk arrin t'ua shpjegojë se nga i vijnë (ndonjë e djegur apo shenjë).
4. Përpquni të vini re sidomos ndryshimet e befta në sjellje dhe pyeteni për këtë.
5. Shihni nëse ka vizatime, grafika apo simbole të tjera në libra a fletore, krahë/këmbë, që mund të tregojnë se mund të jetë përfshirë në grupe të rrezikshme.
6. Vëzhgoni me kujdes sasinë e parave që përdor apo blerjet që bën, të cilat e kalojnë vlerën e parave që i keni dhënë gjatë javës.
7. Flisni rregullisht me mësuesin e fëmijës suaj për shqetësimet që keni.
8. Njihini shokët e fëmijës suaj (e mundësisht edhe prindërit e tyre).
9. Qëndroni vazhdimisht i përfshirë në jetën e fëmijës suaj.
10. Duhet të keni vazhdimisht dijeni se ku ndodhet e çfarë po bën fëmija juaj.
11. Përpquni t'i mbani të angazhuar sidomos pasditeve (ora 15:00 deri në 18:00).





12. Nxitini për pjesëmarrje në aktivitete sportive, klube të ndryshme a aktivitete të tjera të shëndetshme, qofshin edhe vullnetare.
13. Dalloni shenjat që mund të tregojnë se fëmija është i përfshirë në aktivitete, që prekin ligjin, e mos mblyllni sytë, por kërkoni dhe jepni ndihmë.
14. Merrni informacion dhe njihni emrat dhe passëord-et e fëmijës suaj në faqet e medias sociale. Kushtojini vëmendje se çfarë shikojnë, çfarë muzike dëgjojnë, për çfarë flasin dhe çfarë postojnë.
15. Mos harroni se përfshirja e fëmijës suaj në aktivitete të palejuara nuk ndodh brenda një nate. Ndaj duhet të jeni sy-çelët e të vini re çdo sinjal, në mënyrë që ta zgjidhni si duhet përpara se situata të përshkallëzohet.
16. Tregojini fëmijës suaj se e doni dhe kujdeseni për të.



## SHTOJCA NR. 9

Tri nivele: qasja tri-këndore në ndërhyrjet e bazuara në shkollë

### Zona jeshile

Ndërhyrjet e mbështetjes pozitive të sjelljes që janë për të gjithë shkollën do të mbështesin të gjithë fëmijët.


80% e nxënësve

### Zona e kuqe

Ndërhyrje të individualizuara dhe të gjithanshme që fokusohen tek 5% e fëmijëve me vështirësi domethënëse

### Zona e verdhë

Ndërhyrje të hershme për fëmijët në risk do të ndikojnë tek 15% e fëmijëve



Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive janë një sistem që zhvillohet nga shkolla për të përmirësuar sjelljen e nxënësve.



Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive përdoret:

- me të gjithë nxënësit
- në të gjitha mjediset e shkollës (klasë, korridore, oborr, tualete etj)
- që të ndihmojë shkollat për të krijuar mjedise efektive për të mësuar

Pse e përzgjedh zakonisht një shkollë këtë qasje?

Shkollat që zbatojnë Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive janë shkolla që e kanë kuptuar dhe e kanë marrë vendimin se rruga e përdorur më parë prej tyre për të disiplinuar nxënësit nuk është efektive për t'i ndihmuar nxënësit në ndryshimin e sjelljes.

Këto shkolla janë të interesuara për:

1. identifikimin dhe mësimin e sjelljeve të pritshme nga nxënësi
2. gjetjen e rrugëve për të shpërblyer sjelljet e dëshiruara
3. zbatimin e pasoja të qëndrueshme dhe të mençura, në rastet kur thyhen rregullat

Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive janë një mënyrë e planifikuar për të përmbushur nevojat e sjelljes të nxënësve në shkollë. Si prindër jeni shumë të rëndësishëm në suksesin e zbatimit të kësaj qasjeje. Rezultatet e kësaj qasjeje janë më positive, kur prindërit vendosin ta përdorin të njëjtin sistem edhe në shtëpi.



Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive kanë tri hapa kryesorë:

### Hapi i parë: Identifikimi dhe mësimi i sjelljeve të dëshiruara

- d. Identifikoni tri deri në pesë pritshmëri për sjellje të ndryshme në çdo mjedis.
- e. Jepini shembuj se cilat sjellje janë të pritshme në vende të ndryshme (në shtëpi, lagje, autobus etj.).
- f. Shkruajini dhe vendosini pritshmëritë në një vend të dukshëm.

Të mësuarit e sjelljeve të pritshme nënkupton që ekipi i ngritur në shkollë për këtë qëllim duhet të identifikojë se cilat pritshmëri janë në çdo mjedis gjatë ditës në shkollë. Ekipi do të hartojë një model për sjelljet e pritshme në çdo mjedis të shkollës. Ato do të jenë të ndryshme në mjedise të ndryshme. Për shembull le të shohim me kujdes pritshmërinë që lidhet me respektin. Modeli do të përmbajë detaje se si mund “të duket” respekti në klasë, korridor apo oborrin e shkollës.

Shembulli i mëposhtëm është pjesë e një modeli për të mësuar sjelljen e përshtatshme në mjedise të ndryshme të shkollës. (shih modelin)

Kjo është pjesë e një modeli mësimor. Vini re pritshmëritë në korridor dhe oborr. I gjithë stafi i shkollës do të përfshihet në mësimin e sjelljeve të përshtatshme të gjithë nxënësve përmes mësimin, lojës me role dhe praktikimit. Në vend të ndëshkimit të nxënësve për mos-ndjekje të pritshmërive të vendosura, stafi i shkollës duhet të fokusohet më shumë në sjelljet e pritshme pozitive përmes një sistemi shpërblimi dhe përforcimi.



### Hapi i dytë: Përforcimi pozitiv dhe shpërblimi i sjelljeve të pritshme.

Kur nxënësit përmbushin pritshmëritë e vendosura në nivel shkolle, stafi i shkollës do ta vëre re suksesin e tyre e do ta përforcojë pozitivisht. Kjo do të përfshinte vlerësimin apo forma të tjera shpërblimi. Kjo mund të përfshinte dhënien e privilegjeve të vecanta apo vlerësimin në mbledhjet e nxënësve.

### Hapi i tretë: Zbatimi i pasojave të qëndrueshme dhe të mençura kur thyhen rregullat.

Përveç mësimin dhe shpërblimit të sjelljeve pozitive, shkolla duhet të identifikojë një rrugë të qëndrueshme për t'iu përgjigjur sjelljeve problematike kur ato të shfaqen. Strategjitë që do të përdoren për të trajtuar si duhet sjelljet sfiduese, do të ndahen paraprakisht me të gjithë, si me nxënësit, edhe me stafin e prindërit. Kjo gjë bën të mundur që çdokush në shkollë të dijë se cilat sjellje dhunojnë pritshmëritë. Familjet duhet të informohen për të gjithë këtë proces si në formë të shkruar ashtu edhe përmes raportimeve të ndryshme të shkollës. Sjelljet problematike mund të klasifikohen si të vogla ose si probleme madhore. Problemet e vogla menaxhohen nga mësuesi i klasës ose vetë klasa, ndërsa ato madhore menaxhohen nga stafi drejtues ishkolle.

### Nivelet e mbështetjes në nivel shkolle

Shkollat që përdorin Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive krijojnë dhe ruajnë sisteme mbështetjeje për të përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve. Këto mbështetje bazohen në të kuptuarin se sjellje specifike duhen mësuar dhe jo thjesht të pritet nga nxënësit që t'i bëjnë. Megjithatë, edhe përmes përdorimit të Ndërhyrjeve për Sjellje Pozitive rreth 5-10% e nxënësve do të kenë nevojë për mbështetje të mëtejshme për të qenë të suksesshëm.



Më poshtë po përshkruajmë një spektër të vazhduar mbështetjeje për çdo nxënës:

Sistemet universale të mbështetjes (sisteme të mbështetjes së sjelljes në nivel shkolle). Mbështetja e sjelljes sigurohet për të gjithë nxënësit e shkollës. Këto mbështetje përfshijnë:

- Udhëzim për sjellje sociale
- Disiplinë pozitive që është proaktive
- Pritshmëritë për sjelljen e mësuar
- Mbikqyrje dhe monitorim aktiv të nxënësve
- Përforsim pozitiv
- Disiplinë të drejtë dhe korrigjuese
- Trajnim dhe bashkëpunim me prindërit

Sistemet e mbështetjes në grupe të vogla:

Ky nivel mbështetjeje mundëson ndihmë të mëtejshme për 10-15% të nxënësve që kanë nevojë për më shumë mbështetje. Ndërhyrjet janë më intensive për një grup më të vogël nxënësish. Ato realizohen kryesisht në grupe të vogla dhe përfshijnë:

- Grupet e aftësive sociale
- Zgjidhjen e konfliktit
- Programet e menaxhimit të vetes



- Mentorimin e nxënësve nga ana e të rriturve
- Udhëzimin në grup të vogël
- Vendosjen e një orari të veçantë ose uljen në një vend të veçantë

Sistemet e mbështetjes të shënjestruara (të përqendruara te individë të caktuar):

Dhënie e mbështetjes intensive dhe të individualizuar për pak nxënës me sjellje problematike. Këto mbështetje ofrohen kur mbështetjet universale dhe në nivel grupi a klase nuk janë efektive në mësimin e aftësive të sjelljeve të pritshme në të gjitha mjediset e shkollës. Rreth 5-10% e nxënësve kanë nevojë për një nivel më intensiv mbështetjeje. Kjo mund të përfshijë:

- Mbështetjen e individualizuar në mësim
- Udhëzime intensive në mësimin e aftësive sociale
- Vlerësime funksionale të sjelljes
- Hartimin e planeve për ndërhyrje në sjellje
- Supervizimin dhe monitorimin
- Bashkëpunimin me agjensi jashtë shkollës
- Bashkëpunimin intensiv me familjen
- Ndërhyrjet intensive të bazuara te familja, kur është e përshtatshme



## SHTOJCA NR. 10

### NJË LETËR PËR PRINDËRIT: JU E BËNI SHKOLLËN TË JETË AJO QË ËSHTË

Keni ndikimin më të madh në jetën dhe edukimin e fëmijës suaj. Mësuesit dhe shokët e klasës janë të rëndësishëm për të, por ju jeni shumë më të rëndësishëm, ju jeni ata që e keni parë fëmijën përgjatë gjithë viteve. Ju e keni ushqyer dhe mbathur. Ju e keni dashur dhe e keni mësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është e gabuar.

Ndryshimi mes një shkolle të mirë dhe një shkolle shumë cilësore është përfshirja e prindërve. Është e vërtetë se nxënësit, prindërit e të cilëve përfshihen në shkollë, i'a dalin më mirë në shkollë e në jetë. Fëmijët mësojnë t'u japin rëndësi atyre gjërave, që janë të rëndësishme për prindërit e tyre.

Ndoshta ndjeni se nuk keni shumë kohë për t'u përfshirë ose ndoshta nuk dini si të filloni. Nuk duhet shumë kohë për të bërë një ndryshim të madh në edukimin e fëmijës suaj. Vetëm 15 minuta kohë e pandërprerë e shpenzuar me fëmijën çdo ditë mund t'i përmirësojë aftësitë e tij për të nxënë, të krijojë vetë-vlerësim e të ndërtojë rrugën për ta bërë shkollën një përvojë të suksesshme.

Komunikimi me mësuesin dhe stafin e shkollës mund të ndihmojë, gjithashtu. Shënimet e shkurtra për mësuesin për ta njohur me çdo ndryshim në programin e fëmijës apo qoftë edhe për ta falenderuar për mësimet, janë praktika të mira.

Disa prindër mendojnë se është e rëndësishme “ta mbysësh” fëmijën me surpriza në raste të veçanta. Edhe pse është gjë e këndshme për fëmijën, dhurata më e madhe është koha juaj e shpenzuar mirë me të çdo ditë, për nevojat e tij, përfshirë ato arsimore.

Për të qenë një avokat i mirë për fëmijën tuaj, por edhe për të gjithë fëmijët, mësoni se çfarë duhet të prisni nga shkolla e fëmijës suaj.



